



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al)

**Nr.19**

**10 mars**

**2011**

## P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.104, datë 9.2.2011	Për një shtesë në vendimin nr.795, datë 11.7.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strategjisë së zhvillimit të biznesit dhe investimeve për periudhën 2007-2013” .....	687
Udhëzim i MPPT nr.5, datë 17.2.2011	Për disa shtesa e ndryshime në udhëzimin nr.15, datë 24.7.2007 “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor” .....	699
Vendim i KKRT nr.47, datë 21.1.2011	Mbi shqyrtimin e ndryshimit të pronësisë së kuotave të kapitalit themeltar dhe disa të dhënave të tjera të shoqërisë “Teknotrade” sh.p.k., licencuar për subjektin televiziv privat vendor “Tele 1” .....	701
Vendim i KKRT nr.65, datë 11.2.2011	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv privat vendor “Tv Kombi” .....	703
Vendim i KKRT nr.66, datë 11.2.2011	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv privat vendor “Tv Klaudiana” .....	704
Vendim i KKRT nr.68, datë 11.2.2011	Mbi miratimin e ndryshimit të të dhënave të paraqitura në kërkesën për marrje licence nga personi fizik z.Dritan Memushi, licencuar për subjektin televiziv privat kabllor “Tepelena Sat” .....	704
Vendim i KKRT nr.69, datë 11.2.2011	Mbi miratimin e ndryshimit të të dhënave të paraqitura në kërkesën për marrje licence nga shoqëria “Reçi KGM” sh.p.k., licencuar për subjektin televiziv privat kabllor “Tv kabllor Mirdita” .....	706

Vendim i KKRT nr.72, datë 11.2.2011	Për mosrinovimin e licencës së subjektit “House of Arts Radio Television” sh.p.k., për operatorin radiofonik privat vendor “Radio House of Arts”.....	708
Vendim i ERRU nr.1, datë 10.1.2011	Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për sh.a. ujësjellës-kanalizime Pogradec.....	710
Vendim i ERRU nr.2, datë 10.1.2011	Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për sh.a. ujësjellës-kanalizime Lushnjë, qytet .....	711
Vendim i ERRU nr.5, datë 19.1.2011	Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për sh.a. ujësjellës Gramsh.....	711
Vendim i ERRU nr.6, datë 19.1.2011	Për rinovim licence për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor dhe teknik “Elber” sh.p.k.....	712
Vendim i ERRU nr.8, datë 4.2.2011	Për miratimin e modelit të kontratës tip.....	712
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasve: Musa Bardhoshi, Behar Bardhoshi dhe Mirela Bardhoshi.....	723

**VENDIM**  
**Nr.104, datë 9.2.2011**

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.795, DATË 11.7.2007 TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË SË ZHVILLIMIT TË BIZNESIT DHE**  
**INVESTIMEVE PËR PERIUdhËN 2007-2013”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në dokumentin që i bashkëlidhet vendimit nr.795, datë 11.7.2007 të Këshillit të Ministrave, pas shkronjës “b”, të pikës 2.4.2B, shtohet shkronja “c”, si më poshtë vijon:

“c. Programi strategjik për zhvillimin e inovacionit dhe teknologjisë për SME-të, për periudhën 2011-2016, sipas dokumentit që i bashkëlidhet këtij vendimi.”.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**PROGRAMI STRATEGJIK**  
**PËR ZHVILLIMIN E INOVACIONIT DHE TEKNOLOGJISË TË SME-VE PËR PERIUdhËN**  
**2011-2016<sup>1</sup>**

(Shtesë e strategjisë “Për zhvillimin e biznesit dhe investimeve”, miratuar me vendimin nr.795, datë 11.7.2007 të Këshillit të Ministrave)

**Pjesa I. Situata aktuale dhe problemet**

Shqipëria ka regjistruar një rritje të shpejtë në numrin e ndërmarrjeve, fakt i cili tregon një shkallë të lartë të dëshirës sipërmarrëse në vend. Megjithatë, vazhdon të mbetet prapa vendeve të tjera për sa i përket inovacionit. Kjo vë në rrezik konkurrueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e rritjes së ekonomisë dhe punësimit.

Raporti i Progresit 2009 për Shqipërinë nga BE tregon se zhvillimi i SME-ve në Shqipëri është nën mesataren rajonale. Gjithashtu Shqipëria ka një performancë të dobët edhe në inovacion. Ajo renditet në vendin 121 nga 133 në Raportin e Konkurrencës Globale 2010-2011. Kjo pengon konkurrueshmërinë e saj dhe renditet e 88-ta nga 139 shtete (Forumi Ekonomik Botëror f.14). Megjithatë, Shqipëria renditet e 89-ta për sa i përket gatishmërisë teknologjike.

Raporti i vitit 2009 i Bankës Botërore mbi “Rritjen e konkurrencës” vëren se numri i firmave në Shqipëri, të cilat raportojnë se kanë futur në treg një produkt të ri apo të përmirësuar në tri vitet e fundit është shumë i lartë krahasuar me standardet rajonale. 59 për qind e firmave prodhuese në Shqipëri kanë raportuar në vitin 2007 se kanë futur në treg një produkt të ri ose të përmirësuar në tri vitet e fundit, niveli i dytë më i lartë në një grup rajonal krahasimi, pas Kroacisë me 67 për qind (Banka Botërore, 2009, f.31). Firmat shqiptare që futën lloje të ndryshme inovacioni, përjetuan një rritje mesatare më të shpejtë punësimit. Rritja mesatare e punësimit (2004-2006) në mesin e firmave që përmirësuan një linjë ekzistuese në 2006 ishte 43.3 për qind, krahasuar me 19 për qind të firmave që nuk e kryen. Megjithatë, Banka Botërore e konsideron kapacitetin e firmave shqiptare mbi përmirësimin teknologjik si të dobët.

Deficitet manifestohen në sektorët kryesorë të ekonomisë shqiptare. Për sa i përket eksportit,

<sup>1</sup> Dokument i përgatitur me asistencën e projektit IPA 2007 “Për mbështetjen e SME-ve për t’u bërë më konkurruese në tregun evropian”. 687

në to përfshihen veshmbathje, këpucë dhe lëkurë, si dhe produkte agro-ushqimore. Shqipëria ka gjithashtu një sektor TIK në rritje, i cili bën të mundur edhe zhvillimin e sektorëve të tjerë.

OECD (2009:2) vëren se sektori i informacionit dhe teknologjisë së komunikimit (TIK) po rritet me shpejtësi, por përsëri është prapa në nivel rajonal. Ai duhet të përballë me problemet e infrastrukturës, si dhe me cilësinë e forcës punëtore, mungesën e mjeteve të duhura teknologjike për t'i dhënë biznesit njohuritë dhe aftësitë e duhura teknike. Sektori TIK është i rëndësishëm në rolin e tij si mundësues i përmirësimeve të sektorëve të tjerë. Anketime në vitin 2007 tregojnë se numri i firmave shqiptare që po përdorin TIK modern për veprimtaritë e tyre të biznesit është më i ulëti në Europën Lindore. 37 për qind e firmave në Shqipëri që u anketuan në vitin 2007 kishin një faqe interneti, krahasuar me 63 për qind në Europën Juglindore.

Mekanizmat e inovacionit dhe përmirësimit teknologjik

Raporti i Bankës Botërore për rritjen e konkurrencës në Shqipëri (2009) tregon një shkallë të lartë varësie në burimet e huaja të teknologjisë për përmirësim. Në raport thuhet:

“Përmirësimi teknologjik nxitet në një masë të madhe nga dy faktorë kryesorë: i) ekspozimi i firmave ose aksesit në njohuri teknike të huaja më të avancuara; dhe ii) kapaciteti i tyre (dhe nxitja për ta përthithur”.

“Instrumenti më i rëndësishëm [për aksesimin e njohurive teknologjike] ka prirjen të jetë:

i) angazhimi në tregtinë e jashtme; ii) investimi i huaj direkt; dhe iii) “qarkullimi i trurit”, që do të thotë lëvizja ndërkombëtare e individëve me njohuri, përvojë dhe aftësi të avancuara.”.

Për sa i përket tregtisë së jashtme, mundësitë e Shqipërisë janë të kufizuara nga struktura e tregtisë së saj ndërkombëtare. Eksportet e saj mbizotërohen nga veprimtari prodhimi me kosto të ulët pune dhe me vlerë të kufizuar. Ato ofrojnë mundësi të kufizuara për të mësuar nga klientë apo konkurrentë më të sofistikuar në tregjet e huaja. Pothuaj 85 për qind e eksporteve të Shqipërisë buron nga industritë e bazuara intensivisht në burimet natyrore dhe/ose punën e pakualifikuar. Pjesa e importit të mallrave shqiptare që kërkojnë shumë kapital është më e ulëta në SEE <sup>7</sup>. Firmat shqiptare nuk po përfitojnë investime produktive në të njëjtin nivel me vendet fqinje.

IHD kontribuojnë në transferimin e teknologjisë në vendet në zhvillim, me anë të:

a) investimeve të reja; b) transferimit të informacionit dhe njohurive për teknologjinë; dhe c) lehtësimit të përhapjes së teknologjisë te firmat vendase.

Edhe pse investimi i huaj direkt në Shqipëri u rrit në vitin 2008, ai është më i ulëti në gjithë Europën Juglindore. Në nivel cilësor, transferimi i teknologjisë në degët vendase ka qenë i kufizuar (Banka Botërore, 2009, f.7). Shumica e investimeve të huaja për eksport nuk kërkojnë të transferojnë njohuritë dhe teknologjinë te firmat vendase përveç dhënies me qira të pajisjeve dhe njohurive specifike për prodhimin e disa produkteve të caktuara. Financimi i huaj nga korporatat mbetet i papërfillshëm.

Blerja e makinerive dhe pajisjeve është mënyra më e përhapur e futjes së teknologjisë së re. Në anketimin e Bankës Botërore, 95 për qind e firmave prodhuese që kishin futur teknologji të re në tri vitet e fundit e kanë bërë këtë duke blerë makineri dhe pajisje. 38 për qind e firmave prodhuese në studimin e Bankës Botërore për klimën e investimeve (Banka Botërore 2009) raportuan se kanë pasur teknologji të huaj të licencuar brenda këtyre tri viteve të fundit, më shumë se në Kroaci (22 për qind) dhe Bullgari (9 për qind) gjatë së njëjtës periudhë.

Mënyra e dytë më e përhapur për përmirësim (cituar nga 64 për qind e firmave prodhuese) ka qenë punësimi i një personeli të kualifikuar për funksionimin e teknologjisë së huaj, ndërsa 29 për qind e firmave raportuan se ato e kishin zhvilluar ose adoptuar teknologjinë e re brenda ndërmarrjes. 81 për qind e firmave të mesme dhe 92 për qind e firmave të mëdha përmendën punësimin e një personeli për t'i ndihmuar në adoptimin e teknologjisë së re.

Gjenerimi i inovacionit brenda ndërmarrjes është i rëndësishëm. 29 për qind e firmave raportuan se e kishin adoptuar ose zhvilluar teknologjinë e re brenda ndërmarrjes. Kjo është më e rëndësishme për ndërmarrjet më të vogla. 100 për qind e firmave në nivel mikro dhe 58 për qind e

<sup>2</sup> SEE7 përfshin Shqipërinë, Bosnjë dhe Hercegovinën, Bullgarinë, Kroacinë, Maqedoninë, Rumaninë, dhe Serbinë dhe Malin e Zi.

firmave të vogla cituan se kishin zhvilluar teknologjinë e re brenda ndërmarrjes si mënyrën e dytë kryesore për përmirësimin.

Një faktor themelor në kapacitetin e firmave për të përthithur teknologjinë e avancuar është klima e investimeve në të cilën ato operojnë. Kjo përfshin njohuritë, infrastrukturën, normat, sikurse edhe financat. Nga vëzhguesit e jashtëm kjo shihet si e pasigurt dhe ndërmarrjet financojnë zhvillimet kryesisht nga burimet e brendshme, të cilat janë të kufizuara.

Përcaktuesi kryesor i dytë i kapaciteteve absorbuese është niveli i formimit dhe i aftësive teknologjike nëpër firma. Nivelet ekzistuese nuk janë të larta dhe mjetet për përmirësimin e tyre nuk janë zhvilluar sa duhet. Në Shqipëri vetëm 10 për qind e të gjitha firmave të studiuara ofronin trajnim formal për punonjësit e tyre, në krahasim me rreth 79 për qind të firmave sllovaqe të marra në studim në vitin 2005 dhe 48 për qind e firmave në Serbi (Banka Botërore, 2009, f.48). Mekanizmat aktualë të financimit që kanë si qëllim të mbështesin trajnimet e firmave përdoren nga shumë pak prej tyre. Firmat citojnë proceset e tepërta burokratike që përfshihen në një mekanizëm të tillë.

Sipas Bankës Botërore, “Kapaciteti teknologjik” i firmave shqiptare për t’u përmirësuar duke përthithur teknologjitë ekzistuese të avancuara, është i dobët.

#### Struktura mbështetëse

Mekanizmat brenda firmave janë më efikasë për menaxhimin e transferimit të teknologjisë dhe inovacionit. Gjithsesi, kur firmat nuk mund ta menaxhojnë vetë procesin, ato duhet të jenë në gjendje t’u drejtohen mekanizmave kolektivë.

Në raportin e Bankës Botërore citohet: “Shqipëria ka mbetur pas të gjitha vendeve të Europës Lindore në hartimin e politikave proaktive për të mbështetur rritjen e kapacitetit të teknologjisë për ndërmarrjet, veçanërisht për SME-të. Pothuajse, të gjitha veprimtaritë mbi kapacitetin e teknologjisë që ekzistojnë në Shqipëri sponsorizohen nga donatorë dhe nuk ka një strukturë institucionale të dedikuar brenda Qeverisë Shqiptare për bashkërendimin e veprimtarive të tilla<sup>3</sup> me fusha të tjera të politikave siç është arsimit” (Banka Botërore, 2009, f.54).

Nevoja për një strukturë mbështetëse gjithëpërfshirëse ilustron nga rekomandimet e Bankës Botërore, ku përfshihen koordinimi i granteve për trajnim, certifikimi i aftësive, grantet dhe garancitë për blerjen e pajisjeve, standardet e cilësisë, standardet në prodhimin e ushqimit, si dhe standardet dhe testimi i cilësisë nga ana e metrologjisë. Ata prekin shumë aktorë dhe përfshijnë drejtpërdrejt METE-n dhe ministrinë e Punës, Arsimit dhe Bujqësisë.

### **Pjesa II. Vizioni, politikat dhe objektivat prioritarë për inovacionin dhe teknologjinë e biznesit**

Vizioni: Rritja e konkurrencës së ndërmarrjeve shqiptare brenda kontekstit kombëtar, rajonal dhe global, duke inkurajuar dhe mbështetur në mënyrë efektive inovacionin dhe zhvillimin teknologjik në firma, nëpërmjet mbështetjes financiare, teknologjike, informative, infrastrukture dhe të llojeve të tjera, duke përmirësuar kushtet e strukturës, duke krijuar një mjedis të favorshëm për inovacionin e biznesit dhe forcimin e sistemit kombëtar të inovacionit.

Politika e inovacionit dhe teknologjisë së biznesit synon:

- të zhvillojë inovacionin në sektorët kryesorë të ekonomisë shqiptare – rritë ndërgjegjësimin të ndërmarrjet mbi nevojat për inovacion dhe zhvillim të teknologjisë;

- të iniciojë, importojë, modifikojë dhe përhapë teknologji të reja në ndërmarrje;

- të rritë kapacitetin e organizatave mbështetëse të biznesit për të asistuar në inovacionin e ndërmarrjeve;

- të asistojë drejtpërsëdrejti me informacion teknik;

- të asistojë ndërmarrjet për të fituar financime të jashtme për veprimtari inovacioni;

- të mundësojë krijimin e firmave të reja inovative, mbijetesën dhe prosperitetin e tyre.

Politikat e inovacionit dhe teknologjisë së biznesit do të orientohen drejt:

- zhvillimit të inovacionit dhe teknologjisë sipas një perspektive drejt biznesit dhe tregut;

- krijimit të një sistemi inovacioni që do të afrojë gjithë aktorët kryesorë në aktivitetet për

<sup>3</sup>

E theksuar

mbështetjen e ndërmarrjeve;

- krijimit të një lidhjeje logjike dhe mbushjes së boshllëkut midis politikave për zhvillimin e biznesit dhe nxitjes së SME-ve dhe politikës për shkencën dhe zhvillimin e teknologjisë.

Objektivat e zhvillimit të inovacionit dhe teknologjisë së biznesit

Objektivi kryesor i zhvillimit të programit strategjik është:

1. Rritja e aftësisë së bizneseve shqiptare për të zhvilluar, përdorur, përshtatur dhe komercializuar teknologjinë

Kjo do të arrihet nëpërmjet mbështetjes me instrumentet financiare të përshtatshme të orientuara drejt zhvillimit të produkteve të reja dhe stimulimit të SME-ve për të përdorur dhe përshtatur teknologji të reja. Kjo do të kontribuonte në përmirësimin e konkurrencës së industrisë shqiptare si në tregjet vendase, ashtu edhe në ato të huaja. Rritja e kapacitetit teknologjik të SME-ve shqiptare do t'i ndihmojë të konkurrojnë me më efikasitet dhe do të mbështesë integrimin ekonomik të Shqipërisë në tregjet globale. Gjithashtu, përmirësimi i kapaciteteve teknologjike të bizneseve, për t'i bërë ato më konkurruese, do të jetë një hap i rëndësishëm për anëtarësimin e Shqipërisë në BE.

Realizimi i këtij objektivi do të ndikonte në:

- zhvillimin e produkteve të reja të matura me numrin dhe vlerën e financimit të ofruar;  
- rritjen e produktivitetit, produkteve të reja në treg dhe eksporteve të SME-ve përfituese;  
- rritjen e bashkëpunimit midis komunitetit të shërbimeve të biznesit, biznesit dhe industrisë, me qëllim mobilizimin e biznesit rajonal dhe ekspertëve të teknologjisë të matur me numrin e BSP-ve;

- rritjen e infrastrukturës teknologjike, e cila do t'u mundësojë SME-ve mundësinë e përdorimit të shërbimeve të biznesit, kapitalit, pajisjeve të specializuara dhe njohurive të fituara.

2. Mbështetja e inovacionit të biznesit – për ofrimin e ndihmës ndaj ofruesve të shërbimeve të biznesit (BSP), si agjencitë e zhvillimit rajonal (AZHR) dhe këshillimet, për të rritur kapacitetin njerëzor në auditimin e teknologjisë, menaxhimin e inovacionit, dhënien e informacionit, si dhe lehtësimin e financimit për ndërmarrjet. Ky element ofron ekspertizën për t'u siguruar që financimi të ketë përfitime optimale. Pjesë e këtij objektivi është edhe plotësimi i boshllëkut institucional në Sistemin Kombëtar Shqiptar të Inovacionit.

Shqipëria ka aktorë të interesuar nga ana e qeverisë, të cilët kryejnë shumicën e roleve të kërkuara për të bërë funksional një sistem inovacioni.

- Agjencia e Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit (AKTI) mbështet shkencën dhe kërkimet dhe ka për qëllim të nxitë ndërveprimin me bizneset.

- Agjencia e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) mbështet bizneset në lidhje me zhvillimin e eksportit dhe ndërkombëtarizimin e tyre.

- Shërbimi Kombëtar i Punësimit (SHKP) mbështet punësimin, trajnimin dhe vetëpunësimin.

Megjithatë, nuk ekziston asnjë institucion, brenda nënsistemit të mbështetjes, që t'i përfshijë plotësisht bizneset në dinamikën e inovacionit, d.m.th. t'i ndihmojë ato në adoptimin sistematik të inovacioneve dhe në procesin e përthithjes së zhvillimit teknologjik, sikurse edhe të sigurojë ndërveprimet e plota me aktorët e tjerë të interesuar. Ky boshllëk ilustron në figurën e mëposhtme:




Figura 1: Institucionet aktuale mbështetëse brenda Sistemit Kombëtar Shqiptar të Inovacionit




Figura 2: Pozicionimi i BRIC-it brenda Sistemit Kombëtar Shqiptar të Inovacionit

Nisur nga ky boshllëk institucional, do të mbështetet ndërtimi ose zhvillimi institucional i Qendrës së Ndërmjetësimit dhe Inovacionit të Biznesit (BRIC), si një sektor i brendshëm i një organizate ekzistuese qeveritare (AIDA), ose si një institucion plotësisht i pavarur për të bërë të mundur ofrimin e një game të gjerë shërbimesh për mbështetjen teknologjike të ndërmarrjet private të bazuara në njohuritë/dijet.

#### Modeli institucional i BRIC-it

BRIC-i do të drejtojë programet dhe veprimet mbështetëse të propozuara sipas kësaj strategjie të inovacionit. Ai nevojitet të ketë madhësinë e mjaftueshme dhe strukturën e duhur për të drejtuar programet e zhvillimit, të cilat janë planifikuar të realizohen për gjashtë vjet (2011-2016). Në hapat fillestarë BRIC-i shihet i përshtatshëm në formën e një njësie të vogël, me rreth pesë persona në staf, brenda një institucioni ekzistues. I organizuar në këtë formë, ai mund të merret me

programet e para të propozuara që kanë të bëjnë me financimin e inovacionit dhe me rritjen e shërbimeve të inovacionit për bizneset nga BSP-të, si dhe të ndërmarrë rritjen e ndërgjegjësimit. Stafi nuk duhet të ngarkohet me punë të rëndësishme administrative si ato të një organi autonom, të cilat mund të kryhen nga institucioni kryesor (AIDA). Duke qenë fillimisht i organizuar brenda AIDA-s, BRIC-i do të bashkërendohet më mirë me një organizatë që mbështet biznesin, e cila mund të programojë ndërkombëtarizimin për bizneset.

Megjithatë, me zhvillimin e tij, BRIC-i do të nevojitet të jetë autonom për t'iu përgjigjur mundësive, të cilat mund të krijohen në tre deri në gjashtë vite dhe që nuk mund të parashikohen aktualisht. Ai do të bëhet një njësi autonome me një personel prej 20 personash dhe me programe shërbimesh të hartuara për të përmbushur kapacitetin përthithës të ekonomisë shqiptare.

Elementi kryesor në ndërtimin e një sistemi kombëtar të inovacionit është përfshirja e bizneseve nëpërmjet aktiviteteve, të cilat janë të përshtatshme për to. Aktivitetet duhet t'i mundësojnë bizneset të iniciojnë, importojnë, modifikojnë dhe përhapin teknologjitë e reja. Sistemi ka nevojë të gjallërohet nëpërmjet ndërveprimeve midis aktorëve kryesorë. Kjo do të kërkojë përkushtimin e të gjithë aktorëve, si dhe një institucion për nxitjen dhe bashkërendimin e aktiviteteve.

### 3. Zhvillimi i infrastrukturës mundëson:

i) Krijimin e inkubatorëve (si në terma të hapësirës fizike, ashtu edhe në ata të zhvillimit të shërbimeve për mbështetjen e biznesit) me detyrën për të ofruar një mjedis të favorshëm, për të favorizuar suksesin e mundshëm në shfaqjen e iniciativave të reja inovative të biznesit, duke krijuar vende të reja pune, mundësi biznesi dhe rritje të vlerave, nëpërmjet rritjes së shëndetshme të bizneseve të reja inovative.

ii) Mbështetjen e *Cluster*-it të bizneseve në sektorë kyçë, duke ofruar mbështetje për platformat bashkëpunuese, gjë që mund të mundësojë dhe mbështetë bashkëpunimin strategjik midis ndërmarrjeve dhe organizatave të tjera, për rritjen e dimensionit të zinxhirëve të vlerës, duke favorizuar ndërkombëtarizimin, aksesin në tregje të reja dhe/apo përgjigjen ndaj një kërkesë më të sofistikuar.

### **Pjesa III. Programet/projektet kryesore në zbatimin e politikave të inovacionit**

Për implementimin e politikave të inovacionit do të zhvillohen katër programe, si më poshtë:

#### 1. Fondi i inovacionit

Qëllimi i përgjithshëm është rritja e inovacionit nëpër ndërmarrje si një mjet i përmirësimit të konkurrueshmërisë së tyre.

Synimi i fondit të inovacionit është që t'u ofrojë ndërmarrjeve mbështetje të drejtpërdrejtë për zhvillimin e inovacionit. Mbështetja konsiston në rritjen e vlerës së shtuar bruto (GVA) të firmave dhe të arritjeve në produktivitet, nëpërmjet futjes në inovacione të orientuara drejt tregut dhe klientelës. Ky fond do të asistojë firmat në identifikimin e nevojave dhe prioriteteteve të tyre, si dhe në zhvillimin e kapaciteteve të tyre, duke ofruar ekspertizë teknike dhe mbështetje financiare.

Veprimet e programit përqendrohen në asistencën e mundësimit dhe zhvillimit.

- Asistenca e aftësisimit do të ofrojë mbështetje financiare për ndërmarrjet, në formën e subvencioneve, për ekspertë që të auditojnë nevojat e tyre për inovacion dhe teknologji, si dhe për vetë ndërmarrjet që të identifikojnë ofruesit dhe partnerët e teknologjisë në vende të tjera. Këto veprime bëjnë që ndërmarrjet të zgjedhin rrugën optimale të zhvillimit.

- Asistenca e zhvillimit do të ofrojë mbështetje financiare për ndërmarrjet, në formën e subvencioneve dhe kredive të konvertueshme, për investime në produkte të reja, përmirësim të procesit nëpërmjet adoptimit të teknologjisë, zhvillimit strategjik të TIK dhe ndërkombëtarizimit. Ndërmarrjet do të duhet të demonstrojnë se këto investime asistence janë jetike për zhvillimin e konkurrueshmërisë dhe sjellin rezultate konkrete.

#### 2. Shërbimet e inovacionit të biznesit

Qëllimi përfundimtar është që të mundësohen SME-të për të pasur akses në pozicionet e tyre aktuale dhe në opsionet për menaxhimin e inovacionit dhe teknologjisë, si dhe të ndërmarrin zhvillimin optimal.



Për të bërë këtë, është e nevojshme të rritet kapaciteti brenda Shqipërisë dhe të bëhet e mundur që BSP-të dhe ekspertët shqiptarë të asistojnë ndërmarrjet në inovacion dhe përmirësimin e teknologjisë. Kjo përfshin kapacitetin për të ofruar shërbime biznesi dhe shërbime teknike, të njohin rrugët e informimit mbi tregun, shërbimet kryesore teknike, si dhe mbi burimet financiare që mundësojnë inovacionin.

Kapaciteti do të mbështetet me anë të një rrjeti burimesh ekspertize mbi inovacionin. Parashikohet që ky rrjet të integrojë aktivitetet e tij me ato të EEN-së dhe t'i zgjerojë ato në të gjithë Shqipërinë.

Programi përbëhet nga veprimet e mëposhtme:

- Ofrimit të ndërmarrjet e vogla dhe të mesme të shërbimeve të informacionit për inovacionin dhe përmirësimin e teknologjisë.

- Integrimi i BSP-të në sigurimin e informacionit dhe rrjetit të këshillimit të koordinuar nga BRIC-i dhe përmirësuar nga EEN-ja.

- Rritja e kapacitetit të BSP-ve për auditimin e teknologjisë dhe inovacionit në lidhje me menaxhimin e inovacionit.

- Zhvillimi i shërbimeve për lehtësimin financiar për të mundësuar që SME-të të aksesojnë financimin e duhur.

Ndërhyrjet përqendrohen veçanërisht në inovacionin e biznesit dhe zhvillimin teknologjik dhe plotësojnë ndihmën e përgjithshme që do të kryhet në kuadër të Programit Kombëtar të Konkurrueshmërisë që do të kryhet nga projekti “Për mbështetjen e SME-ve për t'u bërë më konkurruese në tregun evropian”.

3. Programi i inkubacionit të biznesit

Qëllimi i programit të inkubacionit të biznesit është zhvillimi i infrastrukturës së përhershme që do të mbështetë shfaqjen e kompanive të reja inovative.

Këtu përfshihen veprime për gjetjen dhe pajisjen e ambienteve, zhvillimin dhe mirëmbajtjen e strukturave mbështetëse të biznesit, sigurimin e një serie të integruar shërbimesh të specializuara, si dhe promovimin e konceptit dhe përmbajtës së inkubacionit të biznesit për aktorët në Shqipëri.

Programi i inkubacionit të biznesit fillimisht do të konsistojë në lançimin e një inkubatori pilot në Tiranë, të lidhur ngushtë me BRIC-in. Në bazë të kësaj eksperience, mësimave të nxjerra dhe mobilizimit të aktorëve dhe burimeve të tjera shtesë do të bëhet një thirrje për mbështetjen e shfaqjes së nismave të inkubatorëve të biznesit në vend.

4. Programi shqiptar i *Cluster-it*

Qëllimi i programit të *Cluster-it*, është që të rritë prodhimin kombëtar me vlerë të shtuar nëpërmjet mbështetjes që u ofrohet *Cluster-ave* me potencialin më të madh për zhvillim. Programi do të stimulojë proceset e krijimit bashkëpunues të vlerave nëpërmjet inovacionit dhe ndërkombëtarizimit. Duhet të mbështetet në një bashkëpunim të ngushtë midis kompanive dhe institucioneve mbështetëse për të arritur sukses në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Programi përcakton synimet e mëposhtme:

- Mbështetjen e zhvillimit rajonal;

- Rritjen e interesimit dhe angazhimit në krijimin e *Cluster-ave* me potencial rritjeje;

- Funksionim më të mirë të bashkëpunimit dhe infrastrukturës;


- Rritjen e kapacitetit të inovacionit;

- Rritjen e ndërkombëtarizimit;

- Rritjen e konkurrueshmërisë brenda *Cluster-ave* dhe prodhimin e përbashkët me vlerë të shtuar.

5. Ofrimi i mbështetjes së integruar për inovacionin e firmave

Programet e mësipërme do të përmbushin nevojat e SME-ve dhe, gjithashtu, do të mbushin boshllëqet kryesore për të mundësuar funksionimin e sistemit të inovacionit. Ato plotësojnë boshllëqet e aktiviteteve për trajtimin e nevojave të ndërmarrjeve dhe, gjithashtu, afrojnë ndërmarrjet për të mbushur boshllëqet e aktorëve të tyre, duke ofruar një mbështetje të integruar për inovacionin e firmave, sikurse tregohet në mënyrë skematike në figurën e mëposhtme.



#### Veprimet mbështetëse në rritje të ndërgjegjësimit

BRIC-i do të promovojë veten në komunitetin e biznesit në Shqipëri, si një burim për përfitimin e tyre. Kjo do të arrihet nëpërmjet aktiviteteve në programe individuale, por megjithatë shtimi i vlerave realizohet nëpërmjet një aktiviteti gjithëpërfshirës.

Objektivi specifik i këtij aktiviteti është bërja e njohur e BRIC-it si një destinacion që ofron një shkallë dhe seri të plotë shërbimesh, me qëllim për të rritur ndërkombëtarizimin, inovacionet dhe konkurrencën e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në Shqipëri.

Katër qëllimet kryesore janë:

- Rritja e ndërgjegjësimit të ndërmarrjeve rreth përfitimeve nga përmirësimi i teknologjisë dhe nga përmirësimi teknologjik në sektorët e synuar për t'i stimuluar që të përmirësojnë pozicionin e tyre konkurrues;
- Promovimi i rolit të BRIC-it për të asistuar ndërmarrjet dhe i rolit të tij si një qendër ekselence për inovacionin e biznesit;
- Plotësimi i promovimit të programeve individuale për inovacion;
- Rritja e përgjithshme e ndërgjegjësimit rreth rëndësisë së inovacionit për përfitime afatgjata sociale dhe ekonomike.

Tabela: Matrica e planit të veprimit 2011-2016

Matrica e Planit të Veprimit 2011-2016															
Nr	Masat	Objektivat	Afatet kohore	Treguesi i Monitorimit	Kosto vjetore						Kostoja totale (mln Euro)	Kostoja e premtuar nga Donatorët (mln Euro)	Kostoja nga Buxheti Kombëtar (*) (mln Euro)	Institucionet përgjegjëse	Donatorët
					2011 (mln Euro)	2012 (mln Euro)	2013 (mln Euro)	2014 (mln Euro)	2015 (mln Euro)	2016 (mln Euro)					
I	Rritja e ndërgjegjësisë		2011-2015	Rritja e ndërgjegjësisë të SME-ve në lidhje me inovacionin dhe zhvillimin teknologjisë	0,029	0,030	0,039	0,044	0,043		0,184	0,000	0,184	BRIC	
	Faqe në Internet		2011-2015	# i vizitave											
	Buletin elektronik		2012-2015	# i çeshtjeve											
	Material promovues	inkurajimi i SME-së për të përmirësuar pozicionin konkurrues nëpërmjet inovacionit;	2012-2015	# i çeshtjeve											
	Deklarata faktesh	promovimi i rolit të BRIC;	2012-2015	# i çeshtjeve											
	Botime	plotësimi i promovimit të programeve individuale;	2012-2015	# i artikujve			100%				100%		100%		
	Shfaqje në media	kuptimi i rëndësisë së inovacionit për përfitime afatgjata ekonomike dhe sociale	2012-2015	# i shfaqjeve											
	Prezantime		2011-2015	# i prezantimeve											
	Aktivitetet		2011-2015	# i aktiviteteve											
	Marrëdhënie me publikun dhe lobim		2011-2015	# i veprimeve											
II	Shërbimet për inovacionin e biznesit		2011-2015	3.5/5 shkalla e kënaqësisë nga ndërmarrjet e asistuara	0,183	0,351	0,282	0,299	0,313		1,429	1,143	0,286	BRIC	IFI
II.1	Prioriteti 1: Informacion dhe Këshillim														
II.1.1	Masa 1.1: Shërbim informimi dhe këshillimi i SME-ve	fuqizimi i SME-së për të vlerësuar pozicionin aktual në menaxhimin e inovacionit dhe arritjen e zhvillimit optimal;	2011-2015	krijimi i i zyrës së suportit	100%	15%	15%	15%	15%		26%	21%	5%		
II.1.2	Masa 1.2: Rrjeti i Ofruesve për Mbështetje Rinovimi		2012-2015	15 anëtarë të rrjetit BSP		10%	5%	5%	5%		6%	4%	1%		
II.2	Prioriteti 2: Ngritja e kapaciteteve të BSP-ve														
II.2.1	Masa 2.1: Menaxhimi i inovacionit	ngritja e kapaciteteve dhe fuqizimi i BSP dhe ekspertëve për të asistuar ndërmarrjet në rinovim dhe përmirësimin e teknologjisë;	2012-2015	40 specialistë të kualifikuar		30%	35%	35%	35%		29%	23%	6%		
II.2.2	Masa 2.2: Auditimi i inovacionit dhe teknologjisë		2012-2015	40 auditues të çertifikuar		40%	30%	30%	30%		29%	23%	6%		
II.3	Prioriteti 3: Lehtësimi i aksesit në financa														
II.3.1	Masa 3.1: Lehtësimi i aksesit në financa		2012-2015	krijimi i zyrës për ndihmën e financimeve		5%	15%	15%	15%		11%	8%	2%		
III	Fondi për rinovim		2011-2015	60 ndërmarrje të mbështetura që tregojnë rritje të GVA në 20%	0,355	0,675	0,979	1,270	1,568		4,848	3,879	0,970	BRIC	IFI
III.1	Prioriteti 1: Nxitja e konkurrencës														
III.1.1	Masa 1.1: Auditimi i inovacionit dhe teknologjisë		2011-2015	300 ndërmarrje të asistuara	17%	17%	17%	17%	17%		17%	14%	3%		
III.1.2	Masa 1.2: Teknologjia ndërkombëtare	mbështetje direkte për ndërmarrjet për të zhvilluar inovacion. Kjo mbështetje ka për qëllim të risë Vlerën e Situar Bruto (GVA) të firmave dhe të stujtë prodhimtarinë	2011-2015												
III.2	Prioriteti 2: Zhvillimi i konkurrencës														
III.2.1	Masa 2.1: Zhvillimi i produktit		2011-2015												
III.2.2	Masa 2.2: Përmirësimi i procesit nëpërmjet adoptimit të		2011-2015	120 ndërmarrje të asistuara	83%	83%	83%	83%	83%		83%	66%	17%		
III.2.3	Masa 2.3: Adoptimi i zgjidhjeve TIK në sektorë të synuar		2011-2015												
III.2.4	Masa 2.4: Ndërkombëtarizimi		2011-2015												
IV	Programi i Inkubacionit të Biznesit		2012-2016	675 vende pune të krijuara direkt pas 3 brezash inkubatorësh start-up		0,083	0,660	0,171	0,225	0,196	1,335	0,855	0,480	BRIC	IPA 3
IV.1	Faza përgatitore	ngritja dhe zhvillimi i një infrastrukture të përsheshme në mbështetje të lindjes së shoqërive inovative fillestare	2012	Faza përgatitore e përfunduar me sukses		100%					6%		6%		
IV.2	Inkubatori pilot i biznesit		2013-2016	75 vende pune krijuar prej firmave			100%	100%	55%	48%	75%	64%	11%		
IV.3	Ngritja dhe zhvillimi i inkubatorëve të rinj të biznesit (**)		2015-2016	2 inkubatorë të rinj					45%	52%	18%		18%		
V	Programi i Cluster-it		2012-2016	GVA e rritur me 10% të ndërmarrjeve në cluster		0,142	0,256	0,628	0,744	0,745	2,514	2,017	0,498	BRIC	IPA 3
V.1	Faza përgatitore		2012	Faza përgatitore e përfunduar me sukses		100%					6%		6%		
V.2	Faza Pilot														
V.2.1	Mbështetje për krijimin e 4 cluster-ave	shtimi i prodhimit kombëtar të vlerës nëpërmjet mbështetjes dhënë cluster-ave me potencialin më të lartë të zhvillimit	2013	4 cluster të rinj të krijuar			100%				10%	9%	2%		
V.3	Faza e plotë e zbatimit														
V.3.1	Mbështetje për krijimin e 2 cluster-ave shtesë		2014-2016	2 cluster shtesë të krijuara				13%			11%	9%	2%		
V.3.2	Mbështetje për krijimin e 6 cluster-ave		2014-2016	10% eksport më i lartë se mesatarja				87%	100%	100%	73%	62%	11%		
Total					0,567	1,281	2,217	2,412	2,893	0,941	10,311	7,893	2,417		

(\*) Në raste të veçanta, mund të lindë nga ndërthurja e Fondeve Kombëtare me projekte specifike të financuara nga Donatorët

(\*\*) Nuk janë konsideruar kostot specifike të 2 inkubatorëve të rinj

#### Pjesa IV: Kostot dhe burimet e financimit për zbatimin e strategjisë


##### Kostot

Buxheti i përgjithshëm për zbatimin e strategjisë së inovacionit dhe teknologjisë së biznesit është rreth 10 milionë euro për një periudhë 6-vjeçare.

Rreth 60% e buxhetit do të alokohet për fondin e inovacionit dhe shërbimet përkatëse të inovacionit; rreth 40% për programet e *Cluster*-it dhe inkubatorit.

Gjatë gjashtë viteve të zbatimit, shpenzimet vjetore parashikohen si më poshtë:

2011	2012	2013	2014	2015	2016	Total
566.500	1.281.000	2.217.000	2.412.249	2.892.966	940.832	10.310.547



##### Buxheti i përgjithshëm, sipas programit/aktivitetit

Programi/aktiviteti	2011	2012	2013	2014	2015	2016	Totali	%
Rritje e ndërgjegjësimit	28.650	30.150	38.750	43.500	43.250		184.300	1,8%
Shërbimet për inovacionin e biznesit	182.650	351.400	282.400	299.050	313.400		1.428.900	13,9%
Fondi për inovacion	355.200	675.300	979.400	1.270.400	1.567.900		4.848.200	47,0%
Programi i <i>Cluster</i> -it	0	141.650	256.450	628.050	743.550	744.550	2.514.250	24,4%
Programi i inkubacionit	0	82.500	660.000	171.249	224.866	196.282	1.334.897	12,9%
<b>TOTALI</b>	<b>566.500</b>	<b>1.281.000</b>	<b>2.217.000</b>	<b>2.412.249</b>	<b>2.892.966</b>	<b>940.832</b>	<b>10.310.547</b>	<b>100,0</b>

##### Buxheti i përgjithshëm, sipas natyrës së shpenzimeve

Programi/Aktiviteti	2011	2012	2013	2014	2015	2016	Totali	%
Personeli i BRIC-it	75.600	160.800	206.400	235.200	282.000	71.160	1.031.160	10,0%
Shpenzimet operacionale	18.900	40.200	51.600	58.800	70.500	17.790	257.790	2,5%
Kostot për trajnim të jashtëm	50.000	200.000	100.000	100.000	100.000		550.000	5,3%
Shërbime të tjera konsulence/ekspertësh	60.000	110.000	90.000	110.000	140.000	100.000	610.000	5,9%
Promovim	30.000	75.000	75.000	70.000	70.000	20.000	340.000	3,3%
Grante – fondi për inovacion	290.000	580.000	870.000	1.160.000	1.450.000		4.350.000	42,2%
Grante – programi i <i>Cluster</i> -it	0	0	120.000	460.000	600.000	600.000	1.780.000	17,3%
Kostot neto të inkubatorit pilot	0	0	640.000	146.249	124.466	94.882	1.005.597	9,8%
Udhëtime – personeli i BRIC-it	25.000	50.000	50.000	50.000	50.000	25.000	250.000	2,4%
Të ndryshme	17.000	57.000	12.000	8.000	4.000	0	98.000	1,0%
Vlerësimi	0	8.000	2.000	14.000	2.000	12.000	38.000	0,4%
<b>TOTALI</b>	<b>566.500</b>	<b>1.281.000</b>	<b>2.217.000</b>	<b>2.412.249</b>	<b>2.892.966</b>	<b>940.832</b>	<b>10.310.547</b>	

##### Burimet e financimit

Buxheti i mësipërm do të financohet nga programet ndërkombëtare donatore nëpërmjet granteve dhe huave (soft), sikurse edhe me kontributin e buxhetit shqiptar. Ky kontribut kombëtar lidhet me komponentin e kërkuar kombëtar të programeve donatore, sikurse edhe me financimin e aktiviteteve, të cilat për shkak të natyrës së tyre dhe/apo afateve kohore, nuk mund të përfshihen në asnjë nga operacionet e mëposhtme të financimit.

Programet / aktivitetet	Burimi i financimit
Shërbimet e inovacionit të biznesit dhe fondi i inovacionit	Nëpërmjet një operacioni specifik financimi me një institucion ndërkombëtar financiar, e tillë si Banka Botërore apo Banka Europiane e Investimeve
Programi i <i>Cluster</i> -ave dhe inkubatori pilot	Nga komponenti mbi konkurrueshmërinë rajonale me ndihmën e ardhshme IPA 3
Të gjitha shpenzimet, të cilat nuk mbulohen nga dy burimet e mësipërme	Buxheti kombëtar

Kontributi i përgjithshëm kombëtar shqiptar do të jetë rreth 2,4 milionë euro, i cili zë afërsisht 23% të buxhetit të përgjithshëm. Ky kontribut përfshin kostot e personelit dhe ato operacionale të BRIC-it si një departament i AIDA. 1,7 milionë euro janë kontributet kombëtare të kërkuara për zbatimin e financimit të huaj (e kushtëzuar). Burimet e detajuara të financimit:

Burimi i financimit		Totali (€)	%
Buxheti kombëtar (*)		655.250	6,4%
Projekt INF	Financim nga INF-i	5.021.680	48,7%
	Kontribut kombëtar	1.255.420	12,2%
IPA 3	Financim nga BE-ja	2.871.467	27,8%
	Kontribut kombëtar	506.730	4,9%
TOTALI		10.310.547	100,0%
(nga të cilat, përpjekja e financimit kombëtar)		2.417.400	23,4%

(\*) ose një kombinim i kësaj me financim specifik donator.

#### Pjesa V: Treguesit monitorues të strategjisë

Zbatimi i planit të veprimit është subjekt i monitorimit sistematik dhe vlerësimit periodik, i cili do të kryhet me vendosjen e një sistemi të menaxhimit të cilësisë nga BRIC-i. Vlerësimi i jashtëm do të kryhet të paktën dy herë (në mes dhe në përfundim) të periudhës 6-vjeçare.

Vlerësimi duhet të integrojë tri nivele:

Niveli	Lloji i vlerësimit
Procesi	Efikasiteti dhe efektiviteti në nxjerrjen e rezultateve.
Rezultatet	Numri i përdoruesve të vërtetë të rezultateve të nxjerra dhe përfitimet specifike. Përshtatshmëria, dobishmëria dhe rëndësia e rezultateve të përfituesit. Kënaqësia e përfituesve. Vlera e rezultateve/përfitimeve për përdoruesin.
Ndikimet	Krijimi i efekteve të qëndrueshme në publikun e synuar. Përsëritje/shumëfishim i efekteve.

Monitorimi dhe vlerësimi do të ndërtohen në mënyrë të tillë që, në njërin anën, integrimi në procedurat operacionale dhe menaxhimit të arrihet plotësisht dhe, në anën tjetër, angazhimi për krahasimin me standardet, veçanërisht me ato në nivelet rajonale dhe europiane, të mund të sigurohet me mënyrën më të rregullt dhe me koston më të ulët të mundshme. Treguesit e përdorur nga BRIC-i në nivelet e monitorimit dhe vlerësimit duhet të reflektojnë, ose do të lidhen me treguesit e përdorur në praktika të njohura për krahasimin e standardevë.

Plani i detajuar i veprimit integron treguesit specifikë vlerësimi dhe objektiva për secilin program, përfshirë periudha kohore se kur duhen të kryhen vlerësimet e jashtme. Sistemi i përgjithshëm i menaxhimit të cilësisë i BRIC-it ka si qëllim të artikulojë me transparencë dhe të integrojë aty ku është e zbatueshme, aktivitete dhe rezultate specifike vlerësimi për çdo program.

Tabela më poshtë tregon një seri treguesish monitorimi, të cilët mbulojnë kuadrin kohor zbatues të planit të veprimit, i cili mund të përdoret si pikë fillimi për krijimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë në BRIC.

Treguesit mbulojnë 22 njësi matëse, si për shembull numrin e ndërmarrjeve të asistuar në inovacionin e biznesit dhe numrin e ekspertëve të kualifikuar dhe auditorët e inovacionit dhe teknologjisë.

Numri i ndërmarrjeve të asistuar në aksesimin e financimeve për inovacion dhe i ndërmarrjeve të reja inovative të inkubuara me numrin e vendeve e punës të krijuara, janë shembuj të tjerë të detajuar në tabelën e mëposhtme.

Treguesit paraprak për Monitorimin e Planit të Veprimit të Inovacionit dhe Teknologjisë së Biznesit, 2011-2016 (\*)

Nr	Masat / Treguesit	Kalendari	Njësia e Matjes	Arritjet vjetore të vlerësuara						Burimet e verifikimit	
				2010	2011	2012	2013	2014	2015		2016
0	<b>Ngritja e BRIC</b>										
		2011-2015	BRIC operacional	në fund të vitit							
		2012-2015	# i stafit të BRIC	5	5	≤ 11	≤ 15	≤ 17	≤ 21	BRIC	
I	<b>Rritja e ndërgjegjësimit</b>										
	Faça e internetit	2011-2015	Faça e Internetit		të zhvilluar	të disponueshëm				BRIC; statistikat e faqes së internetit	
	Buletini elektronik	2012-2015	# i çështjeve vjetore		1	3	3	3	3	BRIC; buletini	
	Evenimente promovionale	2012-2015	# i çështjeve vjetore			6	6	6	6	BRIC; raporte & materiale specifike	
II	<b>Shërbimet për Inovacionin e Biznesit</b>										
II.1	<b>Prioriteti 1: Informacioni dhe Këshillimi</b>										
II.1.1	Masa 1.1: Një shërbim informacioni dhe këshillimi për SME-të dhe organet e tjera	2011-2015	Zyra e Asistencës		ngritur					BRIC	
			# i informacioneve të ofruara		40	120	180	240	300	Monitorimi i Programit	
II.1.2	Masa 1.2: Një rrjet të Ofruesve për Mbështetjen e Inovacionit	2012-2015	# i anëtarëve të rrjetit të BSP-ve		8	10	12	14	16	Monitorimi i Programit	
II.2	<b>Prioriteti 2: Rritja e kapaciteteve të BSP-ve</b>										
II.2.1	Masa 2.1: Menaxhimi i Inovacionit	2012-2015	# i ekspertëve të kualifikuar		10	20	25	30	40	Monitorimi i Programit	
II.2.2	Masa 2.2: Auditimi i Inovacionit dhe Teknologjisë	2012-2015	# i auditorëve të certifikuar		10	20	25	30	40	Monitorimi i Programit	
II.3	<b>Prioriteti 3: Lehtësimi i aksesit në financime</b>										
II.3.1	Masa 3.1: Lehtësimi i aksesit në financime	2012-2015	Zyra për Lehtësimin e Financimeve				ngritur			BRIC	
			# i menaxherëve të SME-ve të trajnuar në gadishmëri inovacioni					20	40	Monitorimi i Programit	
III	<b>Fondi i Inovacionit</b>										
III.1	<b>Prioriteti 1: Mundësimi i Konkurrencës</b>	2011-2015	# i ndërmarrjeve të asistuara		20	40	60	80	100	Monitorimi i Programit	
III.2	<b>Prioriteti 2: Zhvillimi i Konkurrencës</b>	2011-2015	# i ndërmarrjeve të asistuara		8	16	24	32	40	Monitorimi i Programit	
IV	<b>Programi i Inkubatorit të Biznesit</b>										
IV.1	Faza përgatitore	2012	Përgatitja			përfunduar				BRIC; mbështetje specifike	
IV.2	Inkubatori Pilot i Biznesit	2013-2016	# i star-up inovative				3	6	9	12	Raportimi i Inkubatorit
			# i punëve direkte të krijuara				19	38	56	75	Raportimi i Inkubatorit
IV.3	Ngritja dhe zhvillimi i inkubatorëve të rinj të biznesit	2015-2016	# i inkubatorëve të rinj të lançuar						2	Raportimi i Programit	
V	<b>Programi i Cluster-it</b>										
V.1	Faza përgatitore	2012	Përgatitja			përfunduar				BRIC; mbështetje specifike	
V.2	Faza Pilot										
V.2.1	Mbështetje për krijimin e 4 cluster-ave	2013	# i cluster-ave të rinj të krijuar				4			Raportimi i Programit	
V.3	Faza e plotë zbatuese										
V.3.1	Mbështetje për krijimin e 2 cluster-ave shtesë	2014-2016	# i cluster-ave të rinj të krijuar					2		Raportimi i Programit	
V.3.2	Mbështetje për zhvillimin e max. 6 cluster-ave ekzistues	2014-2016	# i cluster-ave ekzistuar të zhvilluar					4	6	6	Raportimi i Programit

(\*) Në varësi të ofrimit në kohë dhe të plotë të të gjitha mjeteve dhe instrumentave të nevojshme ligjore, institucionale, organizative, operacionale dhe financiare

**UDHËZIM**  
**Nr.5, datë 17.2.2011**

**PËR DISA SHTESA E NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.15, DATË 24.7.2007 “PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E LËSHIMIT TË LICENCAVE, AUTORIZIMEVE DHE CERTIFIKATAVE PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË NË TRANSPORTIN RRUGOR”**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, nenit 5 të ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, të ndryshuar, Ministri i Punëve Publike dhe Transportit

**UDHËZON:**

Në udhëzimin nr.15, datë 24.7.2007 “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

**Neni 1**

Në nenin 2 bëhet shtesa si më poshtë:

1. Në pikën 9 pas shkronjës “b” shtohet shkronja “c” me këtë përmbajtje:  
“c. dokument që i jep të drejtën një mjeti për transportin e udhëtarëve, për llogari të vet, brenda dhe jashtë vendit.”.

**Neni 2**

Në nenin 3 bëhen shtesa dhe ndryshimi si më poshtë:

1. Në pikën 1 shtohet shkronja “g” me këtë përmbajtje:  
“g. Shërbimet e transportit të udhëtarëve brenda vendit për llogari të vet.”.
2. Pika 4 shfuqizohet.

**Neni 3**

Pika 1 e nenit 6, ndryshohet si më poshtë:

1. Transporti i brendshëm i udhëtarëve.

<b>Lloji i veprimtarisë</b>	<b>Dokumenti që lëshohet</b>	<b>Autoriteti kompetent</b>
Transporti në linjë të rregullt qytetëse	licencë	bashkia
Transporti në linjë të rregullt rrethqytetëse	licencë	bashkia/komuna
Transporti në linjë të rregullt ndërqytetëse brenda qarkut	licencë	bashkia
Transporti në linjë të rregullt ndërqytetëse ndërmjet qarqeve	licencë	bashkia
Transporti i udhëtarëve me taksi	licencë	bashkia/komuna
Agjenci transporti udhëtarësh e shërbimi taksi	licencë	bashkia/komuna
Transporti për llogari të vet	certifikatë	bashkia/komuna
Shërbimet e rastit	libër udhëtimi	qarku

#### Neni 4

Paragrafi i parë i pikës 5 të nenit 11 ndryshohet si më poshtë:

“5. Certifikatat e mjeteve lëshohen me afat nga 1 vit deri në 5 vjet, sipas kërkesës së personit fizik ose të administratorit ose të autorizuarit prej tij në rastin e personit juridik, dhe në përputhje me dokumentacionin sipas udhëzimit. Afati i vlefshmërisë së certifikatës në asnjë rast nuk duhet të kalojë afatin e vlefshmërisë së licencës.”.

#### Neni 5

Në fillim të nenit 21 shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Licenca për shërbimin taksi jepet nga kryetari i bashkisë ose i komunës përkatëse.

Këshilli bashkiak ose komunal përcakton mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të shërbimit taksi brenda juridiksionit të vet.”.

#### Neni 6

Pas nenit 23 shtohet neni 23/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 23/1

#### **Transporti i udhëtarëve për llogari të vet brenda vendit**

Veprimtaria e transportit të udhëtarëve për llogari të vet brenda vendit, ushtrohet kundrejt certifikatës. Certifikata lëshohet për persona juridikë ose fizikë. Dokumentacioni dorëzohet në bashkinë ose komunën ku ndërmarrja ka selinë e ushtrimit të aktivitetit.

Aplikanti, përveç dokumenteve të përgjithshme sipas pikës 1, 4 dhe 5 të nenit 15 duhet:

- a) në formularin e aplikimit të përcaktojë pikën e hipjes dhe të zbritjes së udhëtarëve;
- b) mjetet dhe drejtuesi i mjetit të jenë në përputhje me shkronjën “b” të pikës 30 të nenit 2 të udhëzimit.”.

#### Neni 7

Në nenin 24 paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë:

“Licenca për ushtrim veprimtarie në transportin rrugor ndërkombëtar të udhëtarëve me autobus lëshohet për persona juridikë ose persona fizikë tregtarë të organizuar në shoqëri transporti.”.

#### Neni 8

Pas nenit 28, paragrafi i parë, pas titullit “Transport rrugor mallrash brenda vendit”, ndryshohet si më poshtë:

“Kamionët me kapacitet transportues nën 1500 kg nuk certifikohen për transport mallrash brenda vendit.”.

#### Neni 9

Paragrafi i parë i nenit 34 ndryshohet si më poshtë:

“Kamionët me kapacitet transportues nën 1500 kg nuk certifikohen për veprimtarinë e transportit ndërkombëtar të mallrave për llogari të vet.”.

#### Neni 10

Certifikatat e mjeteve të lëshuara para hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, janë në fuqi deri në datën e përfundimit të tyre.



Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT  
Sokol Olldashi

**VENDIM**  
**Nr.47, datë 21.1.2011**

**MBI SHQYRTIMIN E NDRYSHIMIT TË PRONËSISË SË KUOTAVE TË KAPITALIT  
THEMELTAR DHE DISA TË DHËNAVE TË TJERA TË SHOQËRISË “TEKNOTRADE”  
SHPK, LICENCUAR PËR SUBJEKTIN TELEVIZIV PRIVAT VENDOR “TELE 1”**

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, i përbërë nga:

Endira Bushati	kryetare
Alban Karapici	zëvendëskryetar
Suela Musta	anëtare
Sami Neza	anëtar
Gent Ibrahim	anëtar
Zylyftar Bregu	anëtar

pasi mori sot në shqyrtim çështjen me:

**OBJEKT:** Për shqyrtimin e ndryshimit të pronësisë së kuotave të kapitalit themeltar dhe disa të dhëna të tjera të shoqërisë “Teknotrade” sh.p.k., licencuar për subjektin televiziv privat vendor “Tele 1”.

**BAZA LIGJORE:** Neni 7 pika 21, neni 20, neni 22 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion e televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

**VËREN SE:**

Shoqëria “Teknotrade” sh.p.k. është licencuar nga KKRT-ja për operatorin televiziv privat vendor “Tele 1”. Me vendimin nr.772, datë 30.1.2009 të KKRT-së, këtij subjekti i është rinovuar licenca për një afat të ri 5-vjeçar.

Me shkresën e datës 10.12.2010, ky subjekt ka paraqitur pranë KKRT-së, njoftimin për ndryshimin e pronësisë së kuotave të kapitalit themeltar dhe administratorit të shoqërisë. Bashkëlidhur kërkesës subjekti ka depozituar Ekstraktin e Qendrës së Regjistrimit Tregtar, lëshuar në datën 10.12.2010.

Sipas këtij ekstrakti rezulton se përfaqësuesi ligjor i shoqërisë “Teknotrade” sh.p.k., është z.Ylli Ndroqi, i cili është edhe ortak i vetëm i shoqërisë me 100% të kuotave.

Gjithashtu, subjekti në datën 13.12.2010, ka dorëzuar në KKRT, njoftimin për ndryshimin e emërimit dhe selisë ligjore të shoqërisë. Kështu shoqëria “Teknotrade” sh.p.k. ka pësuar ndryshime që konsistojnë në emërtimin e shoqërisë dhe selisë së saj.

Nga verifikimi i ekstraktit të regjistrimit tregtar dhe certifikatës për regjistrimin si person i tatueshëm, të datës 13.12.2010, shoqëria “Teknotrade” sh.p.k., rezulton të ketë ndryshuar emërtimin e saj në shoqëria “Channel One” sh.p.k., si dhe ka ndryshuar selinë nga rruga: “Tefta Tashko”, nr.104, Tiranë, në rruga “Aleksandër Moisiu” ish-Kinostudion, Tiranë.

Subjekti ka paraqitur në KKRT njoftimin për ndryshimet e ndodhura në shoqëri, në mbështetje të nenit 30 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion e televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Gjithashtu, bazuar në nenin 22 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, sipas të cilit: “Licenca e transmetimit

është e patjetërsueshme dhe vlen vetëm për subjektin të cilit i është dhënë. Në rast se mbajtësi i licencës hyn në marrëdhënie juridike civile, objekt i të cilave është veprimtaria radiotelevizive e licencuar, atëherë për cedimin ose kalimin e të drejtave që burojnë nga licenca kërkohet miratimi i Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit. Subjekti që ka fituar këto të drejta miratimi i jepet në formën e një licence të re me të njëjtën përmbajtje. Kur Këshilli nuk e miraton kalimin për shkaqe të parashikuara në këtë ligj, i ofron frekuencat që i përkasin kësaj licence për një konkurrim të ri kandidaturash”, është detyrë e KKRT-së shqyrtimi i veprimit juridik të ndryshimit të pronësisë së subjektit të sipërpërmendur.

Nga verifikimi i kryer nga ana e Drejtorisë Juridike dhe e Licencave në KKRT, rezulton se z.Ylli Ndroqi është ortak me 100% të aksioneve në shoqërinë “Ora” sh.p.k., licencuar nga KKRT-ja për subjektin televiziv privat vendor “Ora”.

Konkretisht me vendimin nr.550, datë 28.12.2006, KKRT-ja ka licencuar këtë shoqëri në fushën e transmetimeve tokësore analoge për një periudhë prej 5 vjetësh, për të mbuluar me sinjal rrethet Tiranë dhe Durrës, dhe me vendimet nr.740, datë 7.11.2008 dhe nr.801, datë 17.4.2009, të KKRT-së është miratuar zgjerimi i zonës së licencimit të këtij subjekti në prefekturën Fier dhe qarkun Vlorë. Bazuar në ekstraktin e shoqërisë “Channel One” sh.p.k., z.Ylli Ndroqi rezulton të jetë ortaku i vetëm i shoqërisë me 100% të kuotave.

Neni 20 i ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion e televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, përcakton kufizimet e pronësisë në subjektet që licencohen nga KKRT-ja për transmetime radiotelevizive. Në këtë nen parashikohet se: “...I njëjti subjekt që zotëron një licencë për transmetim televiziv vendor mund të marrë vetëm një licencë të dytë për transmetim radioje vendore”. Duam të sqarojmë se pavarësisht se në rastin konkret kemi të bëjmë me dy subjekte të ndryshme tregtare, këto dy subjekte kanë si ortak të vetëm të njëjtin person fizik (z.Ylli Ndroqi), që zotëron 100% të kuotave si në shoqërinë “Ora” sh.p.k., ashtu edhe në shoqërinë “Channel One” sh.p.k.

Sipas mendimit të shumicës së anëtarëve të KKRT-së, legjislacioni në fuqi e përjashton mundësinë e marrjes së një licence të dytë për transmetim televiziv vendor nga një person fizik, i cili është aksioner i vetëm i një shoqërie të licencuar për transmetim televiziv vendor.

Shumica arrin në këtë përfundim bazuar në përcaktimet ligjore të rasteve të kufizimit të pronësisë në subjektet radiotelevizive, si një faktor që i shërben mbrojtjes së konkurrencës së ndershme dhe parandalimit të monopoleve në fushën e medias elektronike. Parimet e mësipërme përcaktohen qartë si në pikën 4 të nenit 7 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998, të ndryshuar, ashtu dhe në nenin 20 po të këtij ligji (ku parashikohen kufizime qoftë në pjesën e aksioneve që mund të zotërojë një aksioner në një operator rtv kombëtar, qoftë edhe në numrin e licencave që mund të marrë një operator rtv vendor).

Respektimi i parimeve të sipërpërmendura është qartësuar edhe në aktet nënligjore të nxjerra nga KKRT-ja për zbatimin e ligjit nr.8410, datë 30.9.1998, të ndryshuara. Më konkretisht, rregullorja “Për licencimin e operatorëve privatë për transmetim radioteleviziv analogjik tokësor në nivel vendor” (miratuar me vendimin nr.355, datë 29.8.2005 të KKRT-së), saktëson ndarjen midis konceptit të personit juridik dhe atij fizik, lidhur me pronësinë në subjektet rtv.

Kështu, neni 4 i rregullores “Kërkesat për kualifikim”, në pikën 5, parashikon se ndër dokumentet që duhet të dorëzojnë aplikantët që konkurrojnë për t’u pajisur me licencë për operatorë rtv vendore është edhe paraqitja e deklaratës noteriale nëpërmjet së cilës deklarohet se pronari apo ortakët e shoqërisë nuk zotërojnë licencë të mëparshme për transmetim televiziv vendor në rastin e aplikimit për tv vendor, ose që nuk zotërojnë licencë të mëparshme për transmetim radio vendore në rastin e aplikimit në radio FM vendore, si dhe nuk kanë aksione në një shoqëri televizive ose radio kombëtare.

Pavarësisht se në rastin e çështjes objekt shqyrtimi, nuk kemi një aplikim të ri për marrjen e një licence për tv vendor, pasoja e këtij veprimi juridik është e njëjtë (marrja e një licence të dytë për transmetime tv vendore, nga ana e një personi të vetëm). Pra, rregullorja e mësipërme ka ritheksuar kufizimin e përcaktuar në nenin 20 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998, të ndryshuar,

pikërisht për të parandaluar situata si kjo që po shqyrtohet sot nga ky këshill.

Shumica është e mendimit se koncepti “subjekt”, i përmendur në nenin 20 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998, të ndryshuar, nuk duhet parë në kuptimin e ngushtë (*stricto sensu*) apo i veçuar nga konteksti, por duhet kuptuar në harmoni me pjesën tjetër të ligjit, aktet nënligjore, si dhe me legjislacionin në fuqi.

Nëse do të merrnim interpretimin e kundërt, që koncepti “subjekt” në nenin e sipërcituar, është tërësisht i shkëputur nga personi fizik, do të arrinim në paradoksin që një person fizik, duke krijuar persona juridikë të ndryshëm, të mund të blinte aksionet e një numri të pakufizuar subjektsh të licencuar aktualisht nga KKRT-ja për transmetime televizive vendore.

Për gjithë sa më sipër, Drejtoria Juridike dhe e Licencave i ka propozuar KKRT-së mosmiratimin e ndryshimit të pronësisë së kuotave të kapitalit themeltar dhe disa të dhënave të tjera të shoqërisë “Teknotrade” sh.p.k., licencuar për subjektin televiziv privat vendor “Tele 1”.

#### PËR KËTO ARSYE,

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbështetje të nenit 7, pika 21, nenit 20, nenit 22 ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

#### VENDOSI:

1. Të mos miratojë ndryshimin e pronësisë së kuotave të kapitalit themeltar dhe disa të dhënave të tjera të shoqërisë “Teknotrade” sh.p.k., licencuar për subjektin televiziv privat vendor “Tele 1”.

2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 1 muaji në gjykatë në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE  
Endira Bushati

#### VENDIM Nr.65, datë 11.2.2011

#### PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT VENDOR “TV KOMBI”

Në mbështetje të nenit 7, pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

#### VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin televiziv vendor “Tv Kombi”, në fushën e transmetimeve televizive tokësore vendore.

2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.

Ky vendim i shtrin efektet që nga data 8.11.2010 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE  
Endira Bushati

**VENDIM**  
**Nr.66, datë 11.2.2011**

**PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT VENDOR**  
**“TV KLAUDIANA”**

Në mbështetje të nenit 7, pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

**VENDOSI:**

1. Të rinovohet licenca për subjektin televiziv vendor privat “Tv Klaudiana”, në fushën e transmetimeve televizive tokësore analoge.
2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.  
Ky vendim i shtrin efektet që nga data 8.11.2010 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARE**  
**Endira Bushati**

**VENDIM**  
**Nr.68, datë 11.2.2011**

**MBI MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË TË DHËNAVE TË PARAQITURA NË KËRKESËN**  
**PËR MARRJE LICENCE NGA PERSONI FIZIK Z.DRITAN MEMUSHI, LICENCUAR PËR**  
**SUBJEKTIN TELEVIZIV PRIVAT KABLLOR “TEPELENA SAT”**

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, i përbërë nga:

Endira Bushati	kryetare
Alban Karapici	zëvendëskryetar
Suela Musta	anëtare
Sami Neza	anëtar
Gent Ibrahim	anëtar (në mungesë)
Zylyftar Bregu	anëtar,

pasi mori në shqyrtim çështjen me:

**OBJEKT:** Shqyrtimi i kërkesës së paraqitur nga subjekti televiziv privat kabllor “Tepelena Sat”.

**BAZA LIGJORE:** Neni 7 pika 21, neni 22 dhe neni 30 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

**VËREN SE:**

Personi fizik z.Dritan Memushi, është licencuar nga Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, me vendimin nr.428, datë 21.3.2006 të KKRT-së, për subjektin televiziv privat kabllor “Tepelena Sat”, duke u autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat kabllor për të penetruar në qytetin e Tepelenës. Me vendimin nr.512, datë 29.9.2006, KKRT-ja ka vendosur zgjerimin e zonës së licencimit të këtij subjekti në qytetin e Ersekës.

Personi fizik z.Ervid Likollari, është licencuar nga Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit me vendimin nr.18, datë 28.7.2010 të KKRT-së, për subjektin televiziv privat kabllor

“Tv kabllor DCT”, duke u autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat kabllor për të mbuluar me sinjal bashkinë Poliçan dhe komunën Ksamil.

Me shkresën e depozituar në KKRT në datën 1.12.2010, nga ana e subjektit televiziv privat kabllor “Tepelena Sat” është paraqitur në KKRT, kërkesa për miratimin e disa ndryshimeve të ndodhura në këtë subjekt televiziv. Subjekti njofton se nëpërmjet kontratës së shitjes, të datës 20 nëntor 2010, z.Ervid Likollari, licencuar nga ana e KKRT-së, për operatorin televiziv privat kabllor “Tv kabllor DCT”, i ka shitur aktivitetin e tij z.Dritan Memushi.

Sipas kontratës së shitjes depozituar, bashkëlidhur shkresës njoftuese, rezulton se:

“...shitësi pohon se ia shet blerësit kundrejt një çmimi prej 10 500 000 lekë...”

Si dhe,

“Që nga momenti, që palët kanë kryer realisht këtë veprim juridik, shitësi nuk ka më asnjë të drejtë mbi këtë licencë dhe aktivitetin e ushtruar prej saj dhe blerësi bëhet pronar me të drejta të plota dhe pa kushte mbi të gjithë këtë aktivitet televiziv të lartpërmendur. Të gjitha pasojat dhe detyrimet ligjore (taksa-tatime, sigurime shoqërore, energjinë elektrike, ujin e pijshëm, taksat e KKRT-së etj.) të këtij aktiviteti hyjnë në fuqi në momentin e marrjes në dorëzim të aktivitetit...”

Mbështetur në nenin 22 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, sipas të cilit: “Licenca e transmetimit është e patjetërsueshme dhe vlen vetëm për subjektin të cilit i është dhënë. Në rast se mbajtësi i licencës hyn në marrëdhënie juridike civile, objekt i të cilave është veprimtaria radiotelevizive e licencuar, atëherë për cedimin ose kalimin e të drejtave që burojnë nga licenca kërkohet miratimi i Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit. Subjektit që ka fituar këto të drejta miratimi i jepet në formën e një licence të re me të njëjtën përmbajtje. Kur Këshilli nuk e miraton kalimin për shkaqe të parashikuara në këtë ligj, i ofron frekuencat që i përkasin kësaj licence për një konkurrim të ri kandidatash”.

Në mbështetje të nenit 30 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar: “I licencuari detyrohet të njoftojë Këshillin Kombëtar të Radios dhe Televizionit për çdo ndryshim të të dhënave që ka paraqitur në kërkesën për marrjen e licencës... dhe arsyet përkatëse, paraprakisht dhe në çdo rast, jo më vonë se 15 ditë pas bërjes së këtyre ndryshimeve...”.

Nëpërmjet kontratës së shitjes së aktivitetit, subjekti i licencuar nga KKRT-ja “Tv kabllor DCT”, ka hequr dorë nga të drejtat që burojnë nga licenca e transmetimit, prandaj subjekti që i ka fituar ato, ka paraqitur kërkesë për miratimin e këtij ndryshimi, konform parashikimit ligjor.

KKRT-ja konstaton se subjekti që ka fituar të drejtat nëpërmjet kontratës së shitjes është një subjekt, i cili është i licencuar nga KKRT-ja, prandaj miratimi i kërkuar nga neni 22 i ligjit, nuk do të bëhet në formën e dhënies së një licence të re transmetimi, por përmes ndryshimit të të dhënave të paraqitura në kërkesën për marrje licence nga subjekti televiziv privat kabllor “Tepelena Sat”.

Sa më sipër, KKRT-ja e gjen të drejtë e të mbështetur, kërkesën e paraqitur nga subjekti televiziv privat kabllor “Tv kabllor Tepelena Sat”,

#### PËR KËTO ARSYE,

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbështetje të nenit 7, pika 21, nenit 22 dhe 30 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

#### VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të të dhënave të paraqitura në kërkesën për marrjen e licencës nga personi privat fizik z.Dritan Memushi, licencuar për televizionin privat kabllor “Tepelena Sat”.
2. Kalimin e të drejtave të licencës nr.083/RTV kabllor, personit privat fizik z.Dritan Memushi, licencuar për televizionin privat kabllor “Tepelena Sat”.

3. Zgjerimin e zonës së licencimit të subjektit televiziv privat kabllor “Tepelena Sat”, në komunën Ksamil.

4. T’i heqë subjektit person privat fizik z.Ervid Likollari, licencën për televizionin privat kabllor “Tv kabllor DCT”.

5. Licenca nr.083/RTV kabllor bëhet e pavlefshme.

6. Ngarkohet administrata e KKRT-së për veprime të mëtejshme.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARE**  
**Endira Bushati**

**VENDIM**  
**Nr.69, datë 11.2.2011**

**MBI MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË TË DHËNAVE TË PARAQITURA NË KËRKESËN PËR MARRJE LICENCE NGA SHOQËRIA “REÇI KGM” SHPK, LICENCUAR PËR SUBJEKTIN TELEVIZIV PRIVAT KABLLOR “TV KABLLOR MIRDITA”**

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, i përbërë nga:

Endira Bushati	kryetare
Alban Karapici	zëvendëskryetar
Suela Musta	anëtare
Sami Neza	anëtar
Gent Ibrahim	anëtar (në mungesë)
Zylyftar Bregu	anëtar,

pasi mori në shqyrtim çështjen me:

OBJEKT: Shqyrtimi i kërkesës së paraqitur nga shoqëria “Reçi KGM” sh.p.k., licencuar për subjektin televiziv privat kabllor “Tv kabllor Mirdita”.

BAZA LIGJORE: Neni 7 pika 21, neni 22 dhe neni 30 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

**VËREN SE:**

Shoqëria “Reçi KGM” sh.p.k., është licencuar nga Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, me vendimin nr.485, datë 17.7.2006 të KKRT-së, për subjektin televiziv privat kabllor “Tv kabllor Mirdita”, duke u autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat kabllor për të penetruar në qytetin e Rrëshenit.

Personi fizik z.Pëllumb Taka është licencuar nga Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit me vendimin nr.271, datë 30.9.2004 të KKRT-së, për subjektin televiziv privat kabllor “Tv kabllor Lissus”, duke u autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat kabllor për të penetruar në qytetin e Lezhës. Me vendimin nr.142, datë 22.10.2010 të KKRT-së, është miratuar rinovimi i licencës së këtij subjekti për një periudhë tjetër 6-vjeçare.

Me shkresën e depozituar në KKRT në datën 20.12.2010, nga ana e subjektit televiziv privat kabllor “Tv kabllor Mirdita” është paraqitur në KKRT kërkesa për miratimin e disa ndryshimeve të ndodhura në këtë subjekt televiziv. Subjekti njofton se nëpërmjet kontratës së shitjes, të datës 20 nëntor 2010, z.Pëllumb Taka, licencuar nga ana e KKRT-së, për operatorin televiziv privat kabllor “Tv kabllor Lissus”, ka shitur aktivitetin e tij të shoqëria “Reçi KGM” sh.p.k.

Bashkëlidhur kërkesës, subjekti ka paraqitur kontratën e shitjes së nënshkruar para noterit, ekstraktin e regjistrimit tregtar të datës 19.11.2010, për shoqërinë “Reçi KGM” sh.p.k., dhe ekstraktin e regjistrimit tregtar të po kësaj shoqërie të datës 2.12.2010, ku është pasqyruar ndryshimi në objektin e veprimtarisë, duke shtuar edhe veprimtarinë si “Tv kabllor Lissus” në qytetin e Lezhës.

Sipas kontratës së shitjes deponuar, bashkëlidhur shkresës njoftuese, rezulton se shoqëria blerëse “Reçi KGM” sh.p.k.:

“Shoqëria blerëse “Reçi KGM” sh.p.k., merr përsipër vazhdimin e të gjitha kontratave me të tretët, të lidhura deri në datën 20.11.2010 nga ana e z.Pëllumb Taka...”

Si dhe,

“Shoqëria “Reçi KGM” sh.p.k., do të bëjë veprimet e duhura për transferimin e licencës së “Lissus Kabëll” në KKRT, në emrin e shoqërisë “Reçi KGM” sh.p.k...”

Mbështetur në nenin 22 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar: “Licenca e transmetimit është e patjetërsueshme dhe vlen vetëm për subjektin të cilit i është dhënë. Në rast se mbajtësi i licencës hyn në marrëdhënie juridike civile, objekt i të cilave është veprimtaria radiotelevizive e licencuar, atëherë për cedimin ose kalimin e të drejtave që burojnë nga licenca kërkohet miratimi i Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit. Subjekti që ka fituar këto të drejta miratimi i jepet në formën e një licence të re me të njëjtën përmbajtje. Kur Këshilli nuk e miraton kalimin për shkaqe të parashikuara në këtë ligj, i ofron frekuencat që i përkasin kësaj licence për një konkurrim të ri kandidaturash”.

Në mbështetje të nenit 30 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar: “I licencuari detyrohet të njoftojë Këshillin Kombëtar të Radios dhe Televizionit për çdo ndryshim të të dhënave që ka paraqitur në kërkesën për marrjen e licencës..dhe arsyet përkatëse, paraprakisht dhe në çdo rast, jo më vonë se 15 ditë pas bërjes së këtyre ndryshimeve...”

Nëpërmjet kontratës së shitjes së aktivitetit, subjekti i licencuar nga KKRT-ja, “Tv kabllor Lissus”, ka hequr dorë nga të drejtat që burojnë nga licenca e transmetimit, prandaj subjekti që i ka fituar ato, ka paraqitur kërkesë për miratimin e këtij ndryshimi, konform parashikimit ligjor.

KKRT-ja konstaton se subjekti që ka fituar të drejtat nëpërmjet kontratës së shitjes është një subjekt, i cili është licencuar nga KKRT-ja, prandaj miratimi i kërkuar nga neni 22 i ligjit, nuk do të bëhet në formën e dhënies së një licence të re transmetimi, por përmes ndryshimit të të dhënave të paraqitura në kërkesën për marrje licence nga subjekti televiziv privat kabllor “Tv kabllor Mirdita”.

Sa më sipër, KKRT-ja e gjen të drejtë e të mbështetur kërkesën e paraqitur nga subjekti televiziv privat kabllor “Tv kabllor Mirdita”.

#### PËR KËTO ARSYE,

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbështetje të nenit 7, pika 21, nenit 22 dhe 30 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

#### VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të të dhënave të paraqitura në kërkesën për marrjen e licencës nga shoqëria “Reçi KGM” sh.p.k., licencuar për televizionin privat kabllor “Tv kabllor Mirdita”.
  2. Kalimin e të drejtave të licencës nr.018/RTV kabllor, shoqërisë “Reçi KGM” sh.p.k., licencuar për televizionin privat kabllor “Tv kabllor Mirdita”.
  3. Zgjerimin e zonës së licencimit të subjektit televiziv privat kabllor “Tv kabllor Mirdita”, në qytetin e Lezhës.
  4. T’i heqë subjektit, person privat fizik, z.Pëllumb Taka, licencën për televizionin privat kabllor “Tv kabllor Lissus”.
  5. Licenca nr.018/RTV kabllor bëhet e pavlefshme.
  6. Ngarkohet administrata e KKRT-së për veprime të mëtejshme.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARE**  
**Endira Bushat**

**VENDIM**  
**Nr.72, datë 11.2.2011**

**PËR MOSRINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT “HOUSE OF ARTS RADIO TELEVISION” SHPK, PËR OPERATORIN RADIOFONIK PRIVAT VENDOR “RADIO HOUSE OF ARTS”**

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, i përbërë nga:

Endira Bushati	kryetare
Alban Karapici	zëvendëskryetar
Suela Musta	anëtare
Sami Neza	anëtar
Gent Ibrahim	anëtar (në mungesë)
Zylyftar Bregu	anëtar,

pasi mori në shqyrtim çështjen me:

OBJEKT: Shqyrtimi i kërkesës për rinovim licence të paraqitur nga subjekti “House of Arts Radio Television” sh.p.k., licencuar për operatorin radiofonik privat vendor “Radio House of Arts”.

BAZA LIGJORE: Neni 7 pika 21, dhe neni 25 i ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullorja “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.162, datë 29.8.2003 të KKRT-së, nenet 46, 61, 83 e në vijim të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe vendimi nr.196, datë 12.11.2010 i KKRT-së “Mbi shqyrtimin e dokumentacionit për rinovimin e licencës së subjektit “House of Arts Radio Television” sh.p.k., për operatorin radiofonik privat vendor “Radio House of Arts”,

**VËREN SE:**

Me vendimin nr.196, datë 12.11.2010, KKRT-ja ka vendosur paraprakisht të mos rinovojë licencën e subjektit “House of Arts Radio Television” sh.p.k., për operatorin radiofonik privat vendor “Radio House of Arts”, pasi nga shqyrtimi dhe vlerësimi tërësor i dokumentacionit të dorëzuar për rinovimin e licencës, rezultoi se subjekti nuk kishte depozituar garancinë bankare në masën 10% të kapitalit, nuk kishte shlyer sanksionin me gjobë nr.227, datë 28.12.2009 në masën 1 000 000 lekë, nuk kishte paraqitur vërtetim për kontributet e sigurimeve shoqërore për periudhën janar-dhjetor 2007, skemën principale të funksionimit të transmetimit, diagramin H dhe V të antenës për të gjitha pikat transmetuese, si dhe nuk identifikohet autori i projektit teknik. Subjekti nuk kishte paraqitur grilën e strukturës programore dhe se dokumentacioni i programacionit ishte dorëzuar i pafirmosur.

Subjekti kishte të drejtën e ankimit në KKRT brenda 1 muaji. Me shkresën e datës 24.12.2010, subjekti “House of Arts Radio Television” sh.p.k., ka depozituar vërejtjet përkatëse (pretendimet) mbi vendimin e sipërcituar të KKRT-së, si dhe dokumentacionin plotësues për rinovimin e licencës. Nëpërmjet saj, radio “House of Arts” pretendon se shkaqet që kanë diktuar marrjen e vendimit nr.196, datë 12.11.2010 të KKRT-së, nuk qëndrojnë, me arsyetimin si më poshtë vijon:

“...Është joserioze të refuzosh miratimin, sepse “nuk identifikohet autori i projektit teknik” apo “dokumentacioni i paraqitur për programet nuk është i firmosur”. Këto nuk përbëjnë shkak ligjor për mosrinovimin e licencës... pretendimi se subjekti “nuk ka shlyer sanksionin me gjobë nr.227, datë 28.12.2009, në masën 1 000 000 lekë”, KKRT-ja, si palë e paditur, është plotësisht në dijeni se kundër gjobës në fjalë është formuar ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë... “Pretendimi i tretë determinant i KKRT-së është se subjekti “nuk ka paraqitur kontributet e sigurimeve shoqërore për periudhën janar-dhjetor 2007”. Sipas pikës 6 të rregullores (rregullorja “Për rilicencimin e



operatorëve privatë radiotelevizivë, miratuar me vendimin nr.162, datë 29.8.2003 (shënim yni), subjekti aplikues duhet të paraqesë dhe pagesat e sigurimeve shoqërore për punonjësit e siguruar. Sidoqoftë, rregullorja nuk specifikon nëse detyrimi për të paraqitur pagesat e sigurimeve shoqërore shtrihet në 1 vit, 2 vite, në 3 apo më shumë vite. Kjo është një mangësi e rregullores, e cila nuk mund të interpretohet në kurriz të aplikuesve”.

Për sa u përket pretendimeve që ka paraqitur subjekti lidhur me dokumentacionin e aplikimit, KKRT-ja konstaton se, bazuar në ligjin nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, në nenin 23, parashikohen kërkesat për marrjen e licencës. Më konkretisht: “Kërkesa për marrjen e licencës së transmetimit radioteleviziv përmban:...

5. objektin dhe karakteristikat e përgjithshme të shërbimit,... projektin teknik të instalimit dhe shfrytëzimit;...

8. përmbajtjen e programeve që do të transmetohen dhe strukturën programore të propozuar për transmetim;...

9. raportin e kohës së transmetimit që do të zënë emisione të prodhuara vetë...”.

Siç rezultojnë, ndër kriteret e parashikuara për marrjen e licencës është projekti teknik, si dhe struktura programore, kushte të cilat nuk mund të nënvlerësohen apo të konsiderohen si dokumente më pak të rëndësishme apo me më pak vlerë juridike. Nga ana tjetër, bazuar në aktet nënligjore në fuqi (rregullorja “Për licencimin e operatorëve privatë për transmetim radioteleviziv analogjik tokësor në nivel vendor”, rregullorja “Mbi kriteret për dhënie e licencave për transmetime televizive dhe radio FM analoge tokësore në nivel vendor”, miratuar me vendimin nr.355, datë 29.8.2005 dhe rregullorja “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.162, datë 29.8.2003 (rregullore e zbatuar gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të depozituar nga subjekti “House of Arts” nga ana e KKRT-së), si për licencimin e operatorëve rtv ashtu edhe për rilicencimin, kërkesat e parashikuara më lart janë kushte të domosdoshme kualifikuese gjatë procesit të shqyrtimit të dokumentacionit të aplikuesve.

Lidhur me dokumentacionin që vërteton pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore për vitin 2007, KKRT-ja vëren se, gjatë procesit të shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar nga ana e subjekteve rtv, kriter vlerësues është edhe pagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore, e konkretisht pika 6 e rregullores “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.162, datë 29.8.2003 (rregullore e zbatuar gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të depozituar nga subjekti “House of Arts” nga ana e KKRT-së).

Pavarësisht se subjekti pretendon se mangësitë që kanë diktuar miratimin e vendimit nr.196, datë 12.11.2010 të KKRT-së, nuk janë të mjaftueshme për të mbështetur vendimin refuzues të KKRT-së, rezultojnë se me shkresën nr.1927 prot., datë 24.12.2010, subjekti “House of Arts Radio Television” sh.p.k., ka depozituar dokumentacionin plotësues për rinovimin e licencës.

Nga ana tjetër, KKRT-ja konstaton se me vendimin nr.6309, datë 27.7.2010, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka lënë në fuqi sanksionin me gjobë nr.227, datë 28.12.2009 të KKRT-së, duke rrëzuar pretendimin e palës paditëse për pavlefshmëri të saj. Është e vërtetë që subjekti ka ankimuar vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në Gjykatën e Apelit, por deri më tani nuk ka vendim të gjykatës për pezullimin e ekzekutimit të masës së gjobës. Neni 329 i Kodit të Procedurës Civile, parashikon se:

“Paditësi mund t’i kërkojë gjykatës edhe pezullimin e zbatimit të aktit administrativ...”, kërkim, i cili nuk është bërë nga ana e subjektit radiofonik “House of Arts” në procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Bazuar në rregulloren “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, pika 4.3 (sepse në bazë të kësaj rregulloreje është kryer shqyrtimi i aplikimit për rinovimin e licencës), përcaktohet se “Gjatë shqyrtimit të kërkesave për rinovimin e licencave do të kenë vlerësim kualifikues... detyrimet financiare sipas ligjit për periudhën që ka ushtruar aktivitetin, ku përfshihet... pagimi i gjobave eventuale, të vendosura nga KKRT-ja”. Nga ana tjetër, bazuar në nenin 137/4 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në

Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, gjoba është titull ekzekutiv që vilet nga KKRT-ja dhe derdhet në Buxhetin e Shtetit. Subjekti ka ushtruar ankimin përkatës në KKRT ndaj sanksionet me gjobë nr.227, datë 28.12.2009, e cila me vendimin nr.6, datë 29.1.2010 ka vendosur lënien në fuqi të kësaj gjobe. Nga verifikimi i kryer, rezulton se nga ana e këtij subjekti nuk është shlyer sanksioni i mësipërm.

Sa më sipër, KKRT-ja e gjen kërkesën e shoqërisë “House of Arts Radio and Television” sh.p.k., për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik privat vendor “House of Arts” të pambështetur në ligj.

#### PËR KËTO ARSYE,

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbështetje të nenit 7, pika 21, dhe nenit 25 ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.162, datë 29.8.2003 të KKRT-së,

#### VENDOSI:

1. Të mos rinovojë licencën me nr.050/FML të subjektit radiofonik privat vendor “Radio House of Arts”.
  2. Licenca me nr.050/FML bëhet e pavlefshme.
  3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.
  4. Ngarkohet administrata e KKRT-së për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARE**  
**Endira Bushati**

#### VENDIM

**Nr.1, datë 10.1.2011**

#### **PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË UJIT PËR KONSUM PUBLIK PËR SHA UJËSJELLËS-KANALIZIME POGRADEC**

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21 të ligjit nr.8102 datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, si dhe metodikës “Mbi vendosjen e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, në zbatim të këtij ligji, Komisioni Kombëtar Rregullator i ERRU-s

#### VENDOSI:

1. Të miratojë tarifat e ujit për konsum publik për sh.a. ujësjellës-kanalizime Pogradec, si më poshtë:

	Për ujin e pijshëm	Për ujërat e ndotura
Konsumator familjar:	55 lekë/m <sup>3</sup>	18 lekë/m <sup>3</sup>
Institucione buxhetore:	110 lekë/m <sup>3</sup>	25 lekë/m <sup>3</sup>
Ente private:	110 lekë/m <sup>3</sup>	25 lekë/m <sup>3</sup>
Tarifë fikse shërbimi 40 lekë/muaj/klient.		

2. Pagesa rregullatore do të jetë 1% e të ardhurave vjetore të llogaritura.

3. Ky vendim hyn në fuqi më 1.1.2011 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

KRYETARI  
Avni Dervishi

**VENDIM**  
**Nr.2, datë 10.1.2011**

**PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË UJIT PËR KONSUM PUBLIK**  
**PËR SHA UJËSJELLËS-KANALIZIME LUSHNJË QYTET**

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21 të ligjit nr.8102 datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, si dhe metodikës “Mbi vendosjen e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, në zbatim të këtij ligji, Komisioni Kombëtar Rregullator i ERRU-s

**VENDOSI:**

1. Të miratojë tarifat e ujit për konsum publik për sh.a. ujësjellës-kanalizime Lushnjë qytet, si më poshtë:

	Për ujin e pijshëm	Për ujërat e ndotura
Konsumator familjar:	44 lekë/m <sup>3</sup>	12 lekë/m <sup>3</sup>
Institucione buxhetore:	100 lekë/m <sup>3</sup>	16 lekë/m <sup>3</sup>
Ente private:	110 lekë/m <sup>3</sup>	18 lekë/m <sup>3</sup>

Tarifë fikse shërbimi 100 lekë/muaj/klient.

2. Pagesa rregullatore do të jetë 0.8% e të ardhurave vjetore të llogaritura.

3. Ky vendim hyn në fuqi më 1.1.2011 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

KRYETARI  
Avni Dervishi

**VENDIM**  
**Nr.5, datë 19.1.2011**

**PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË UJIT PËR KONSUM PUBLIK**  
**PËR SHA UJËSJELLËS GRAMSH**

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21 të ligjit nr.8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, si dhe metodikës “Mbi vendosjen e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura” në zbatim të këtij ligji, Komisioni Kombëtar Rregullator i ERRU-s,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë tarifat e ujit për konsum publik për sh.a. Ujësjellës Gramsh, si më poshtë:

	Për ujin e pijshëm
Konsumator familjar:	32 lekë/m <sup>3</sup>

Institucione buxhetore: 90 lekë/m<sup>3</sup>  
Ente private: 90 lekë/m<sup>3</sup>  
2. PAGESA RREGULLATORE DO TË JETË 1% E TË ARDHURAVE VJETORE TË LLOGARITURA.  
3. Ky vendim hyn në fuqi më 1.1.2011 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

KRYETARI  
Avni Dervishi

**VENDIM**  
**Nr.6, datë 19.1.2011**

**PËR RINOVIM LICENCE PËR EFEKT TË NDRYSHIMIT TË DREJTUESIT LIGJOR DHE  
TEKNIK "ELBER" SHPK**

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17 të ligjit nr.8102, datë 28.3.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.958, datë 6.5.2009 "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë....." Komisioni Kombëtar Rregullator

**VENDOSI:**

1. Të rinovohet licenca e operatorit "Elber" sh.p.k. me:
  - drejtues ligjor: z.Ardjan Sotir Zhidro;
  - drejtues teknik: z.Astrit Hasan Mënalla.
2. Operatori: "Elber" sh.p.k. autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategoritë:
  - Kategoria A, për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik.
  - Kategoria C, për largimin e ujërave të ndotura.
3. Zona e shërbimit të këtij operatori është:

bashkia:	Elbasan
komuna:	Bradashesh.
4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare, deri në datën 19.1.2015.

KRYETARI  
Avni Dervishi

**VENDIM**  
**Nr.8, datë 4.2.2011**

**PËR MIRATIMIN E MODELIT TË KONTRATËS TIP**

Në mbështetje të nenit 3, të nenit 13 pikat "d" dhe "g", të nenit 14 pikat "d", "e", "h", "i" dhe "j", dhe nenit 19 pika 3/b të ligjit nr.8102, datë 28.3.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Miratimin e modelit të kontratës së shërbimit ujësjellës-kanalizime, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Palët që nënshkruajnë këtë kontratë, janë operatorët e shërbimit të ujësjellës-kanalizime dhe klientët e tyre.

3. Zbatimi i këtij modeli kontrate do të jetë i detyrueshëm për të gjithë operatorët e licencuar nga Komisioni Kombëtar Rregullator.

4. Enti Rregullator i Ujit, në rast të moszbatimit të këtij vendimi nga palët e mësipërme dhe mungesës së regjistrimit të konsumatorëve, nuk miraton tarifën për shërbimin e ujit apo dhënien e licencave për shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve.

5. Modeli i kontratës do të zbatohet nga operatorët e ujësjellës-kanalizime, sipas një plani veprimi të miratuar nga Komisioni Kombëtar Rregullator.

KRYETARI  
Avni Dervishi

KONTRATË  
PËR SHËRBIME UJËSJELLËS-KANALIZIME

NR. \_\_\_\_\_

NDËRMJET

\_\_\_\_\_ i quajtur "Operatori" pajisur me licencë të ushtrimit të aktivitetit nga ERRU, nr. \_\_\_\_\_ datë \_\_\_\_\_ përfaqësuar nga \_\_\_\_\_, me adresë në rrugën \_\_\_\_\_, adresa postare \_\_\_\_\_, nr. telefoni/fax \_\_\_\_\_ dhe konsumatorit si më poshtë:

KONSUMATOR FAMILJAR	KONSUMATOR PUBLIK	KONSUMATOR PRIVAT	TË DHËNA PËR UJËMATËSIN
Emri Mbiemri	Emri i institucionit, organit, entit publik	Emri tregtar NR NIPT _____	Data e instalimit Vendi i instalimit
Nr.dok. të identifikimit	Përfaqësuesi i autorizuar	Përfaqësuesi i autorizuar	Numri i ujëmatësit
Numri i telefonit/fax	Numri i telefonit/fax	Numri i telefonit/fax	Kapaciteti i ujëmatësit
Adresa Adresa postare	Adresa Adresa postare	Adresa Adresa postare	Numri i modelit Vendi i prodhimit Jetëgjatësia

Shërbimet që ofrohen	Vetëm furnizimi me ujë <input type="checkbox"/>	Vetëm grumbullim, largim dhe përpunim të ujërave të ndotura <input type="checkbox"/>	Furnizimi me ujë dhe grumbullim, largim dhe përpunim të ujërave të ndotura. <input type="checkbox"/>
----------------------	--	---	---

Duke nënshkruar këtë kontratë, përfaqësuesit e autorizuar të palëve kanë rënë dakord për sa më poshtë:

1. Kjo kontratë përbëhet nga kushtet e përgjithshme dhe aneksi 1, dhe bazohet në legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

2. Fatura e lëshuar nga operatori për shërbimet e ofruara përbën “Titull ekzekutiv”, sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

3. Konsumatori bie dakord për detyrimet ndaj operatorit, taksat dhe tatimet në fuqi në momentin e nënshkrimit të kontratës dhe ndryshimet që mund të pësojë kontrata gjatë kohëzgjatjes së saj.

4. Nëse konsumatori nuk kryen pagesën e faturës brenda datës 28 të muajit pasardhës, ai duhet të paguajë kamatëvonesën prej 0,5% të vlerës së faturës për çdo ditë vonese, por jo më shumë se 10% të vlerës së faturës.

5. Në rast mospagese brenda 30 ditëve kalendarike pas afatit të mësipërm, operatori ka të drejtë të ndërpresë furnizimin me ujë vetëm pasi ka njoftuar me shkrim konsumatorin të paktën 5 ditë kalendarike përpara.

6. Pagesa do të bëhet në \_\_\_\_\_

7. Çdo konsumator ka të drejtën të bëjë kërkesë/ankesën pranë zyrave të operatorit.

8. Kontrata hartohet në 2 kopje dhe secila nga palët mban një kopje.

PËR OPERATORIN:

Emri: \_\_\_\_\_

Nënshkrimi/vula: \_\_\_\_\_

Data: (d/m/v): \_\_\_\_\_

PËR KONSUMATORIN:

Emri: \_\_\_\_\_

Nënshkrimi/vula: \_\_\_\_\_

Data: (d/m/v): \_\_\_\_\_

#### Neni 1

### Qëllimi i kontratës

Kjo kontratë rregullon marrëdhëniet juridike midis palëve për shërbimin e furnizimit me ujë dhe të kanalizimeve të ujërave të ndotura në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### Neni 2

### Përkufizime

Në këtë kontratë termat e mëposhtëm do të kenë kuptimin që vijon, përveç kur përcaktohet ndryshe në nenet specifike:

1. “Konsumatorë” janë të gjithë konsumatorët familjarë, publikë dhe privatë, të cilët përdorin shërbimet ujësjellës-kanalizime.

2. “Operatori” është subjekti i licencuar nga ERRU, që ushtron aktivitetet e shërbimit në sistemet e furnizimit me ujë, grumbullimit, largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura dhe ofron një ose disa nga këto shërbime sipas kategorive të përcaktuara në licencë.

3. “Palët” janë operatorët dhe konsumatorët e referuar së bashku në këtë kontratë.

4. “Enti Rregullator i Ujit (ERRU)” është institucion që kontrollon dhe rregullon sektorin e furnizimit me ujë, të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura.

5. “Komisioni” është Komisioni Kombëtar Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura, që funksionon në bazë të ligjit nr.8102, datë 28.3.1999 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar.

6. “Ujë” kuptohet uji për konsum, përfshirë ujin e pijshëm, që shërbehet përmes sistemit të furnizimit me ujë dhe që plotëson standardet e kërkuara nga legjislacioni në fuqi.

7. “Sistemi i furnizimit me ujë” përbëhet nga tërësia e elementeve, si: vepra e marrjes së ujit, sistemi i pompave, rezervuarët, linjat e transmetimit dhe rrjeti shpërndarës.

8. “Ujëmatës” është instrument matës i instaluar për të përcaktuar sasinë e ujit të konsumuar.

9. “Pika e lidhjes së ujit” është pika e përcaktuar nga operatori në linjat e rrjetit shpërndarës për të realizuar lidhjen e furnizimit me ujë të konsumatorit me sistemin e furnizimit me ujë.

10. “Ujëra të ndotura”, ujërat që përdoren për qëllime hidrosanitare dhe industriale, grumbullimi, largimi dhe trajtimi i të cilave është urdhëruar për shëndetin dhe komoditetin publik.

11. “Sistemi i kanalizimeve” është sistemi i kanalizimeve të ujërave të ndotura që përbëhet nga linjat e shkarkimit, kolektorët kryesorë, stacionet e pompimit të ujërave të ndotura, impianti i trajtimit të ujërave të ndotura (nëse sistemi është i pajisur me një të tillë) dhe vepra e shkarkimit të tyre në trupën ujore pritëse.

12. “Pika e shkarkimit të ujërave të ndotura” është pika e përcaktuar nga operatori në linjat e sistemit të kanalizimeve për të realizuar lidhjen e sistemit të grumbullimit të ujërave të ndotura të konsumatorit brenda pronës së vet me sistemin e largimit të ujërave të ndotura.

13. “Impianti i trajtimit të ujërave të ndotura” është tërësia e njësive operacionale që trajtojnë ujërat e ndotura urbane dhe/ose industriale sipas standardeve në fuqi.

14. “Shërbime ujësjellës-kanalizime” është tërësia e shërbimeve të kryera nga operatorët të konsumatorët përmes sistemeve të furnizimit me ujë, si dhe sistemeve të grumbullimit, largimit dhe/ose trajtimit të ujërave të ndotura.

15. “Legjislacioni në fuqi” nënkupton të gjitha aktet ligjore e nënligjore të zbatueshme në Republikën e Shqipërisë.

## SEKSIONI I SHËRBIMET E UJËSJELLËS-KANALIZIME

### Neni 3

#### **Shërbimi i furnizimit me ujë dhe i kanalizimeve**

1. Për shërbimin e furnizimit me ujë sipas ligjit në fuqi, operatori është përgjegjës:

a) për operimin, mirëmbajtjen, rehabilitimin, rinovimin dhe modifikimin e sistemit të furnizimit me ujë;

b) për furnizimin me ujë të konsumatorit në mënyrë të vazhdueshme gjatë 24 orëve të çdo dite të vitit sipas standardeve në fuqi të cilësisë së ujit. Në rast se operatori nuk mund ta ofrojë këtë shërbim, atëherë duhet të marrë masa që të ofrojë shërbimin më të mirë të mundshëm. Në këtë rast, operatori duhet të njoftojë konsumatorin për orët e furnizimit me ujë, në mënyrë që konsumatori të marrë masa për të përballuar mungesat e përkohshme;

c) për administrimin e sistemit të furnizimit me ujë deri te pika e lidhjes.

2. Për shërbimin e kanalizimeve, operatori është përgjegjës për:

a) largimin e disiplinuar të ujërave të ndotura, që gjenerohen në pronën e konsumatorit dhe që lidhet me sistemin e kanalizimeve në zonën e shërbimit të operatorit, si dhe trajtimin e tyre përpara shkarkimit në trupën ujore pritëse (në rast se zona e shërbimit është e pajisur me impiant trajtimi);

b) mirëmbajtjen e elementeve përbërëse të sistemit të kanalizimit të ujërave të ndotura;

c) operimin dhe mirëmbajtjen e impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura;

d) administrimin e sistemit të kanalizimeve të ujërave të ndotura nga pika e shkarkimit të ujërave të ndotura deri te vepra e shkarkimit në trupën ujore pritëse.

3. Operatori nuk ka të drejtë të bëjë mbylljen e sistemit të furnizimit me ujë apo të kanalizimeve të ujërave të ndotura pa lajmëruar më parë konsumatorin dhe pa i dhënë mundësinë atij për shpjegime brenda një kohe të arsyeshme, përveç kur parashikohet ndryshe në këtë kontratë.

4. Kur është e nevojshme dhe në bashkëpunim me autoritetet përkatëse, operatori mund të njoftojë zyrtarisht konsumatorin drejtpërdrejt apo nëpërmjet medias që të kursejë ujin sipas kërkesave të caktuara.

#### Neni 4

### **Ndërprerja e përkohshme e shërbimeve nga operatori**

1. Operatori përcakton kohën dhe riparimet e nevojshme në sistemin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve. Në rast ndërprerjeje për punime të planifikuara, operatori duhet të njoftojë konsumatorët nëpërmjet medias, të paktën 3 ditë përpara datës së ndërprerjes, për grafikun e përkohshëm të furnizimit me ujë dhe datën kur do të rifillojë grafiku i zakonshëm.

2. Operatori mund të pakësojë ose përkohësisht të ndërpresë shërbimin e furnizimit me ujë, të kanalizimeve ose cilindo prej shërbimeve për të cilat është licencuar, për shkak të defekteve të papritura në sistemet përkatëse ose në secilin prej elementeve që lidhin sistemet me konsumatorin, edhe pa njoftuar konsumatorin. Në këtë rast, operatori duhet të njoftojë konsumatorin për intervalin dhe arsyen e ndërprerjes.

3. Në rastet e emergjencave, forcave madhore ose defekteve të rënda të sistemeve të furnizimit me ujë apo kanalizimeve, të cilat mund të zgjatin më shumë se 24 orë, operatori duhet të plotësojë kërkesat e shërbimeve sipas një plani emergjence të aprovuar.

#### Neni 5

### **Cilësia e ujit dhe autoritetet përgjegjëse**

1. Operatori është përgjegjës dhe merr masat e duhura për kontrollin e rregullt të cilësisë së ujit në përputhje me standardet e përcaktuara në legjisllacionin në fuqi.

2. Operatori kryen trajtimin, dezinfektim, klorimin e ujit të pijshëm dhe garanton që treguesit fiziko-kimikë të tij të jenë në përputhje me standardet e cilësisë si përcaktohet në legjisllacionin në fuqi.

3. Operatori ka përgjegjësinë dhe mbikëqyr kushtet higjieno-sanitare të sistemeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve në përputhje me legjisllacionin në fuqi.

4. Operatori e ndërpret shërbimin e furnizimit me ujë nëse vërtetohet se nuk plotësohen standardet e cilësisë së ujit, duke njoftuar menjëherë konsumatorin për arsyet e kësaj ndërprerjeje.

#### Neni 6

### **Mbrojtja e mjedisit dhe trajtimi i ujërave të ndotura**

1. Operatori është përgjegjës dhe merr masat e duhura për trajtimin e shkarkimin ujërave të ndotura në përputhje me standardet e përcaktuara në legjisllacionin në fuqi.

2. Çdo operator që sipas licencës shkarkon ujëra të ndotura të trajtuar në trupat ujorë, duhet të ketë leje mjedisore përkatëse, në përputhje me legjisllacionin në fuqi.

3. Operatori në bashkëpunim me autoritetet përgjegjëse garanton dhe merr masa për të ulur në vijimësi sasinë e ujërave të ndotura që shkarkojnë në mjedisin pritës.

4. Operatori ka përgjegjësinë dhe mbikëqyr kushtet higjieno-sanitare të sistemeve të kanalizimit sipas legjisllacionit në fuqi.

#### Neni 7

### **Ujëmatësit**

1. Operatori duhet të instalojë ujëmatësin për çdo konsumator sipas legjisllacionit në fuqi.

2. Operatori detyrohet të furnizojë, të instalojë, të mbikëqyrë dhe të zëvendësojë ujëmatësin.

3. Operatori merr masat e nevojshme për cilësinë dhe funksionimin e ujëmatësit, sipas standardeve të përcaktuara nga legjisllacioni në fuqi. Operatori është përgjegjës për jetëgjatësinë e ujëmatësit sipas kësaj kontrate.

4. Konsumatori detyrohet për shpenzimet e furnizimit dhe të instalimit të ujëmatësit sipas faturës që jepet nga operatori.

5. Operatori duhet të njoftojë një muaj përpara konsumatorin për zëvendësimin e ujëmatësit



në fund të jetëgjatësisë së tij, sipas listës së ujëmatësve që ka hartuar vetë operatori.

6. Nëse njëra nga palët dyshon se ujëmatësi nuk funksionon në rregull, atëherë operatori duhet ta heqë ujëmatësin dhe të fillojë procedurat e verifikimit të funksionimit dhe riparimit ose zëvendësimit të ujëmatësit sipas legjislacionit në fuqi. Ujëmatësi i ri ose i kolauduar duhet të vendoset nga operatori brenda 30 ditëve nga dita që operatori e ka konstatuar defektin apo nga dita që konsumatori ka paraqitur kërkesën me shkrim lidhur me funksionimin jo të rregullt të ujëmatësit tek operatori. Operatori e njofton konsumatorin me shkrim për përfundimin e procedurave të verifikimit. Shpenzimet për procedurat e mësipërme janë përgjegjësi e operatorit nëse provohet se ujëmatësi nuk funksionon në rregull dhe është përgjegjësi e konsumatorit nëse provohet se ujëmatësi funksionon në rregull. Nëse vërtetohet se ujëmatësi nuk ka funksionuar si duhet për arsye teknike dhe si pasojë vlerësimi i sasisë së ujit të konsumuar është bërë mbi bazën e leximeve të pasakta, operatori është përgjegjës për vlerën e faturës së fundit tatimore. Nëse vërtetohet se ujëmatësi funksionon si duhet, konsumatori detyrohet për vlerën e faturës së fundit tatimore.

7. Nëse ujëmatësi dëmtohet pa dashje nga konsumatori apo si pasojë e kushteve atmosferike, konsumatori duhet të njoftojë operatorin brenda 5 ditëve. Operatori regjistron raportimin dhe i jep konsumatorit një konfirmim zyrtar me shkrim me datën e raportimit dhe datën kur ka ndodhur dëmtimi.

a) Operatori duhet të marrë masa që të zëvendësojë ujëmatësin brenda 30 ditëve nga data e raportimit.

b) konsumatori që nuk njofton operatorin brenda 5 ditëve, detyrohet të paguajë:

i) konsumatori jofamiljar - pesëfishin e vlerës së faturës tatimore të muajit të fundit;

ii) konsumatori familjar - dyfishin e vlerës së faturës tatimore të muajit të fundit.

c) Shpenzimet për heqjen, rivendosjen ose zëvendësimin e ujëmatësit janë përgjegjësi e konsumatorit në rastet e dëmtimit pa dashje.

8. Konsumi i ujit gjatë kohës që mungon ujëmatësi do të llogaritet sipas konsumit mesatar mujor të llogaritur gjatë vitit të fundit.

## SEKSIONI II TARIFAT DHE PAGESAT

### Neni 8

#### **Tarifat**

1. Të gjitha tarifat miratohen nga ERRU në bazë të një procesi transparent sipas legjislacionit në fuqi.

2. Asnjë tarifë apo pjesë e saj nuk mund të modifikohet më shumë se një herë brenda vitit.

3. Tarifat e miratuara hyjnë në fuqi në datën e përcaktuar në vendimet përkatëse dhe bëhen publike nga ERRU. Operatori duhet të njoftojë konsumatorin me shkrim dhe nëpërmjet medias brenda 30 ditëve nga marrja e vendimit për tarifat e reja.

### Neni 9

#### **Faturat**

1. Fatura e konsumit të ujit të pijshëm është titull ekzekutiv.

2. Operatori është përgjegjës për lëshimin e faturave mujore. Procedurat e leximit të ujëmatësit vendosen nga operatori dhe aprovohen nga ERRU.

3. Fatura duhet t'i dorëzohet konsumatorit në vendin e banimit, në mënyrë zyrtare (me postë ose dorazi) dhe jo më vonë se 15 ditë përpara afatit të pagesës.

4. Fatura duhet të përmbajë në mënyrë të qartë të paktën elementet që vijojnë:

a) Emri, mbiemri, kodi i identifikimit dhe adresa e konsumatorit;

b) Të dhënat e ujëmatësit, elementet e sigurisë dhe mënyra e identifikimit të ujëmatësit;

- c) Datat e sakta të leximeve;
  - d) Vlera e marrë nga leximi apo nëse është përcaktuar pa lexim;
  - e) Sasinë e ujit të konsumuar gjatë periudhës midis dy leximeve;
  - f) Çmimin e saktë për njësi dhe sipas sasisë nëse ndryshon;
  - g) Tarifa për shërbimin e furnizimit me ujë dhe/ose të kanalizimeve, në të cilën përfshihet edhe tarifa e shfrytëzimit të burimeve ujore;
  - h) Tarifat fikse, siç janë tarifa e shërbimit, e rilidhjes apo të tjera kur aplikohen;
  - i) Taksat e aplikueshme dhe llogaritja e tyre;
  - j) Çmimin total për shërbimin para dhe pas aplikimit të taksave dhe tatimeve.
5. Për konsumatorët që nuk kanë ujëmatës, konsumi i ujit llogaritet sipas legjislacionit në fuqi. Në këtë rast, fatura tregon shprehimisht se konsumatori nuk ka ujëmatës dhe mënyrën e llogaritjes së vlerës së faturës.

#### Neni 10 Pagesa e faturës

1. Konsumatori duhet të paguajë detyrimin brenda datës (28) të muajit pasardhës të sportelet e caktuara të operatorit, nëpërmjet kontove bankare ose sipas mënyrave të tjera për të cilat kanë rënë dakord palët.
2. Nëse pagesa nuk kryhet brenda afatit, konsumatori duhet të paguajë kamatëvonesën sipas legjislacionit në fuqi.
3. Nëse pagesa nuk kryhet brenda 30 ditëve pas kalimit të afatit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, operatori ka të drejtë të ndërpresë furnizimin me ujë. Operatori mund të ndërpresë furnizimin me ujë vetëm nëse e ka njoftuar me shkrim konsumatorin të paktën 5 ditë përpara. Njoftimi me shkrim duhet të përmbajë edhe tarifën për rilidhjen që zbatohet në këtë rast.

#### Neni 11 Ankesat për faturat

1. Konsumatori që nuk është dakord me vlerën e faturës, ka të drejtë të paraqesë ankesë me shkrim pranë operatorit brenda 10 ditëve nga dita e marrjes në dorëzim të faturës.
2. Konsumatorit duhet t'i jepet një konfirmim zyrtar me shkrim nga operatori që vërteton datën e dorëzimit dhe numrin përkatës të regjistrimit të ankesës.
3. Operatori duhet të shqyrtojë, të marrë vendim dhe të njoftojë konsumatorin mbi ankesën brenda 10 ditëve nga data e regjistrimit të ankesës.
4. Nëse operatori nuk e njofton konsumatorin brenda afatit të caktuar, atëherë konsumatori nuk është i detyruar të paguajë kamatëvonesën për faturën për të cilën është ankuar.

### SEKSIONI III TË DREJTAT DHE DETYRIMET E KONSUMATORIT

#### Neni 12 E drejta e konsumatorit për t'u dëmshpërblyer

1. Konsumatorit i lind e drejta për t'u dëmshpërblyer:
  - a) në rastet e ndërprerjeve teknike që zgjasin më shumë se 24 orë, të cilat nuk janë shkaktuar nga forca madhore, nga vendosja e gjendjes së jashtëzakonshme apo emergjenca, si dhe kur nuk janë njoftuar më parë dhe kanë penguar konsumatorin nga përdorimi i këtyre shërbimeve për një periudhë më të gjatë se 24 orë;

b) kur uji i furnizuar nuk plotëson standardet e kërkuara nga legjislacioni në fuqi dhe si pasojë i shkakton dëme konsumatorit.

2. Konsumatori kryen procedurat për t'u dëmshpërblyer në përputhje me parashikimet e bëra në këtë kontratë dhe me legjislacionin në fuqi.

### Neni 13

#### **Detyrimet e konsumatorit**

1. Konsumatori është përgjegjës për administrimin e rrjetit të brendshëm të ujësjellës-kanalizimeve brenda pronës së vet. Konsumatori duhet të bëjë përpjekje të arsyeshme për të mbrojtur ujëmatësin dhe sistemin e ujësjellës-kanalizimit nga abuzimet, dëmtimet apo aktet kriminale.

2. Konsumatori ndalohet:

- a) të furnizojë me ujë persona të tretë;
- b) të përdorë ujin për qëllime të tjera të ndryshme nga ato për të cilat i është ofruar;
- c) të bëjë ndërhyrje apo lidhje në sistemin e furnizimit me ujë, si dhe në sistemin e kanalizimeve pa marrë më parë miratim nga operatori;
- d) të dëmtojë në çfarëdolloj mënyre elemente, pjesë apo vetë sistemin e furnizimit me ujë dhe të kanalizimeve;
- e) që, vetë apo duke lejuar të tretët, të bëjë lidhje në rrjetin shpërndarës jashtë ujëmatësit, të heqë apo të shkëmbejë ujëmatësin.

3. Konsumatori ndalohet të ndërhyjë apo të lejojë ndërhyrje tek ujëmatësi apo tek elementet e sigurisë pa aprovimin e operatorit. Vetëm persona të autorizuar nga operatori mund të ndërhyjnë tek ujëmatësi në prezencë të konsumatorit.

4. Konsumatori duhet të njoftojë menjëherë operatorin apo çdo institucion tjetër që është i autorizuar të kontrollojë e të mbikëqyrë sistemet e ujësjellës-kanalizimeve nëse vëren ndryshime, ndërhyrje të paligjshme, dëmtime apo abuzime me sistemin e ujësjellësit apo kanalizimeve.

5. Konsumatori duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme që të parandalojë dhe të shmangë shpërdorimin, ndotjen ose helmimin e ujit. Në rast se dyshon ose vëren shpërdorim, ndotje ose helmim të ujit, të njoftojë menjëherë operatorin.

6. Konsumatori duhet të informojë menjëherë operatorin nëse ka ndryshime në adresën postare ose në numrin telefonik të kontaktit.

### Neni 14

#### **Hyrja në pronën e konsumatorit**

1. Operatori duhet të njoftojë konsumatorin dhe të koordinojnë mundësinë e hyrjes në mjediset e tij në orare të përshtatshme për të dyja palët.

2. Konsumatori duhet të lejojë përfaqësuesin e autorizuar të operatorit, kundrejt dokumentit zyrtar që vërteton autoritetin e tij si përfaqësues i operatorit, të hyjë në ambientet e tij në çdo ditë të javës gjatë orëve të zakonshme të punës, me qëllim që:

a) të kontrollojë kushtet e punës të ujëmatësit apo të çdo elementi tjetër të sistemeve të ujësjellësit dhe kanalizimeve. Kjo përfshin marrjen e masave të menjëhershme nëse është e nevojshme;

b) të ndërpresë shërbimin sipas kushteve të kësaj kontrate;

c) të kryejë kontrolle për të verifikuar cilësinë e ujit.

SEKSIONI IV  
PEZULLIMI DHE ZGJIDHJA E KONTRATËS

Neni 15

**Pezullimi i kontratës nga konsumatori**

1. Konsumatori, i cili për arsye të ndryshme dëshiron të ndërpresë përkohësisht shërbimet e ujësjellës-kanalizimeve, mund ta pezullojë kontratën me operatorin. Konsumatori i paraqet operatorit kërkesën me shkrim për ndërprerjen e furnizimit me ujë, duke treguar datën e fillimit dhe të mbarimit të ndërprerjes. Kjo kërkesë duhet të paraqitet jo më vonë se 15 ditë para datës së kërkuar për ndërprerje.

2. Operatori e regjistron kërkesën dhe i jep konsumatorit një konfirmim me shkrim që tregon datën kur është regjistruar kërkesa dhe datat e ndërprerjes dhe rilidhjes së shërbimit. Operatori është përgjegjës për realizimin teknik të ndërprerjes dhe lidhjes së shërbimit në datat e kërkuara nga konsumatori.

3. Kur konsumatori nuk përcakton datën e rilidhjes së shërbimit, duhet të paraqesë kërkesën me shkrim që tregon datën kur duhet të rilidhet shërbimi.

4. Operatori e regjistron kërkesën dhe i jep konsumatorit një konfirmim me shkrim që tregon datën kur është regjistruar kërkesa dhe datën e rilidhjes së shërbimit. Operatori është përgjegjës për realizimin teknik të rilidhjes së shërbimit brenda 3 ditëve nga data e kërkuar nga konsumatori.

5. Shpenzimet e ndërprerjes dhe rilidhjes do të paguhet nga konsumatori. Operatori mund t'i përfshijë këto shpenzime në faturën mujore ose të dërgojë një faturë të veçantë vetëm për ato shpenzime. Kjo faturë duhet të paguhet brenda afatit të pagesës së faturës mujore të konsumatorit.

6. Nëse konsumatorit për arsye të ndryshme nuk i nevojitet furnizimi me ujë për një periudhë kohore të caktuar, por nuk bën pezullimin e kontratës për atë periudhë, atëherë mban përgjegjësi për anomalitë që krijohen në sistemet e ujësjellës-kanalizimeve gjatë asaj periudhe, të cilat nuk janë shkaktuar nga faktorë të jashtëm.

Neni 16

**Zgjidhja e kontratës nga konsumatori**

1. Konsumatori ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kësaj kontrate në çdo kohë dhe për çdo arsye.

2. Konsumatori duhet që jo më vonë se 15 ditë para datës së zgjidhjes së kontratës t'i paraqesë operatorit kërkesën me shkrim, duke përcaktuar datën dhe shkaqet e zgjidhjes së kontratës.

3. Operatori regjistron kërkesën dhe i jep konsumatorit një konfirmim me shkrim me datën e regjistrimit dhe që tregon datën e zgjidhjes së kontratës.

4. Konsumatori është përgjegjës për të gjitha detyrimet kundrejt operatorit deri në datën e zgjidhjes së kontratës. Nëse konsumatori nuk i paguan detyrimet, ndaj tij do të ndiqen procedurat ligjore në fuqi dhe ato të parashikuara në këtë kontratë.

5. Operatori është përgjegjës:

a) të kontrollojë që konsumatori ka paguar të gjitha detyrimet deri në datën e zgjidhjes së kontratës;

b) të realizojë teknikisht ndërprerjen e shërbimit në datën e zgjidhjes së kontratës.

6. Kur konsumatori kalon të drejtën e pronësisë të të tretët (pronari i ri), aplikohet procedura e mësipërme e zgjidhjes së kontratës. Operatori lidh kontratë të re me pronarin e ri, bazuar në kërkesën e këtij të fundit.







